



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

TË VËRTETAT E VONUARA

Rexhep Qosja

Botuar nga: Toena

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë autorit dhe botuesit

QËLLIMET E KUNDËRTA.....	5
SA MË LARG NGA E KALUARA KOMUNISTE.....	8
QËNDRIMET KUNDËRMYSLIMANE.....	11
ESADIZMI.....	13
REAGIMET NDAJ POLEMIKËS	16
TË GJITHË PORTRETISTËT E MI	18
VETËM E VËRTETA I BASHKON NJERËZIT	21
KU E LAMË KOSOVËN?.....	22
BESIMI DHE MOSBESIMI.....	23
KRAHASIME QË S'BËHEN	25
SOVJETIZIMI DHE EVROPIANIZIMI	28
SI PO ZGJIDHET ÇËSHTJA KOMBËTARE	30
KATEGORI E NDRYSHUESHME.....	32
LETRARËSIA DHE PAVARËSIA?	34

KRYEMINISTRI I GJITHKUNDSHËM	37
DEDUCTIO AD ABSURDUM (1).....	43
DEDUCTIO AD ABSURDUM (2).....	45
CONCLUSIO.....	47
DORA E GJATË E KRYEMINISTRIT.....	48
TIPOLOGU I NACIONALIZMIT	52
EDHE KRYEPARLAMENTARJA FUTET NË POLEMIKË.....	55
SHNDËRRIMET E LEVERDISHME	58
PËRFUNDIM	65

Të gjithë flisnin përnjëherë. Zërat i kishin të fortë, kundërshtues dhe të padurueshëm. Jorealitetin e kthenin në mundësi, mandej në parashikim, mandej në fakt të pamohueshëm, ashtu siç bëjnë gjithmonë njerëzit kur dëshirat u shndërrohen në fjalë.

Vilijem Fokner, Zhurmë dhe tërbim

Bota mëshirplotë dhe piktoreske e të verbërve të mirë ka marrë fund, tani është mbretëria e egër, mizore dhe e pamëshirshme e të verbërve. Sikur të shihje atë që shoh unë, do të dëshiroje të ishe i verbër. Të besoj!

Hoze Saramago, *Verbëri*

QËLLIMET E KUNDËRTA

Populli thotë: më mirë vonë se kurrë.

Vazhdoj të besoj në etikën intelektuale me të cilën jam pajisur duke lexuar rilindësit tanë dhe mendimtarët evropianë: luftoju mashtrimet edhe në qoftë se lufta duket e kotë. Kurrë s'është vonë.

Kam pritur shumë reagime në trajtesën *Realiteti i shpërfillur* me të cilën i jam përgjigjur polemikës së Ismail Kadaresë ndaj pikëpamjeve të mia mbi identitetin kombëtar dhe vetëdijen fetare, por në

asnjë rast nuk kam pritur që aq shumë ngjyrë politike dhe ideologjike do të hidhet në fytyrën time!

Kjo përgjigje e dytë ndaj polemikës së dytë, në të vërtetë ndaj pamfletit të Ismail Kadaresë me titullin *Pabesia e një polemisti*, të botuar në gazetën *Shekulli*, më 17 maj 2006 dhe, pastaj, të ribotuar në disa gazeta edhe në Prishtinë, përpos në gazetën *Epoka e re*, në të cilën është botuar përgjigjja ime *Realiteti i shpërfillur*, botohet me vonesë. Dhe, kjo vonesë ishte e detyrueshme: ishte pasojë e pjesëmarrjes së shumë vetjeve në këtë polemikë midis tij dhe meje, qoftë me shkrime në gazetatat e Tiranës e të Prishtinës, qoftë me letra e artikuj në forume të ndryshme në internet. Megjithëse reagimet vazhdojnë, sado më rrallë, konsideroj se nuk është e nevojshme të pritet më shumë: mendimet kryesore janë thënë, ndjenjat më të papërmbajtura, ndoshta, janë shprehur.

Përgjigjja ime, prapë, do të jetë e gjatë por, megjithatë, shumë më e shkurtër se pamfleti i Ismail Kadaresë bashkë me pamfletet e disa prej miqve të tij, që janë kujdesur aq shumë të më “përpunojnë” ideologjikisht, politikisht dhe fetarisht, duke më vënë përpara turli flamujsh!

Qëllimi i përgjigjes sime dallon rrënjësisht prej qëllimit të pamfletit të Ismail Kadaresë. Ndërsa ai shkruan me pezëm, *ab irato*, dhe ka për qëllim kryesor të më fyejë, madje, si e thotë lehtësisht njëri nga reaguesit, të më përbuzë, qëllimi im është krejtësisht tjetër: qëllimi im është që të shpjegoj çështjet e ngritura ashtu siç duhet t'i shpjegojë njeriu që nuk pranon të zëvendësohen arsyeja me urrejtjen e argumenti me mashtrimin, domethënë qëllimi im është që të bëj një përgjigje që do të mund të ishte e dobishme për letërsinë, për historinë e letërsisë, për kulturën dhe, ndoshta, për politikën tonë. Si as në përgjigjen e parë, *Realiteti i shpërfillur*, as tani, në të dytën, unë, natyrisht, nuk i lejoj vetes t'i shmangem rolit që ka intelektualit në jetën kulturore, politike dhe shoqërore në

përgjithësi e që është, siç është thënë shumë herë përpara meje prej shumë intelektualëve: kuptimi dhe shpjegimi objektiv, i ndershëm i njëmendësisë. Të dhënat që sjell, përfundimet që bëj prej përimtimit të tyre, mund të jenë të padëshiruara, madje, të hidhura, qoftë për vetje, qoftë për grupe, por unë nuk fyej dhe nuk përbuz kënd. Fyerja dhe përbuzja nuk ishin mjet imi në asnjë kohë - pavarësisht sa e ngrysur mund të ishte ajo dhe në asnjë situatë - pavarësisht sa kërcënuese mund të ishte ajo.

Si lexues i veprave të Ismail Kadaresë, prandaj edhe i intervistave dhe përgjigjeve që ka dhënë ai për gjykimet e të tjerëve mbi krijimtarinë e tij, kam parë se ai me lehtësi ka shqiptuar shpesh fyerje dhe përbuzje për ata, të cilët për veprën e tij dhe për të nuk mendojnë e nuk shprehen siç do të donte ai. Fyerja dhe përbuzja janë dëshmuar kështu si mjet i tij i shpeshtë në qerimin e hesapeve me oponentët në diskutimet mendore. Më kujtohet se si një kritik, të mospajtuar me të, do ta quante plehurinë, një tjetër plehërishte, një të tretë halldup, një të katërt gërxfho! Më kujtohet se si bamirësin e vet të dikurshëm do ta quajë homoseksual! Më kujtohet se si “plehurinat”, “plehërishtet”, “halldupët”, “gërxfhot”, “homoseksualët” kur e kur do t’i quajë edhe tradhtarë, kurse simbolin e luftës së Kosovës për pavarësi, Adem Demaçin do ta quajë “mendje të tharë dhe pa atdhe”!

Siç dihet, në përbuzjen gjithmonë mbështetet ideologjia e racizmit. Ata që e dinë se sa gojëlëshuar është shkrimtari Ismail Kadare, mund të jetë se nuk janë befasuar shumë kur në sprovën e tij mbi *Identitetin evropian të shqiptarëve*, me të cilën i është përgjigjur trajtesës sime *Ideologjia e shpërbërjes*, kanë parë se ai nuk përmbahet nga përbuzja ndaj botës islame e kjo domethënë nuk përmbahet nga shprehja e racizmit ndaj kësaj bote!

Të jem i sinqertë: nuk kam pritur se mund të jem i fyer prej tij jo vetëm për një sërë arsyesh për të cilat nuk mund të flas këtu, por edhe për arsye se në trajtesën time *Ideologjia e shpërbërjes*, kundër së cilës është ngritur me sprovën *Identiteti evropian i shqiptarëve*, askund nuk e kam përmendur dhe nuk e kam përmendur sepse në asnjë rast nuk kam menduar për të. As nuk e kam përmendur Ismail Kadarenë në atë trajtesë, as nuk kam cituar në çfarëdo mënyre ndonjë vepër, intervistë a deklaratë të tij. Pse, atëherë, ai e fillon këtë polemikë? Pse, atëherë, ai shkruan një librushkë kundër meje? Pse, atëherë, ai më fyen me fjalët që kurrë nuk do t'i prisja prej tij? Pse, atëherë, ai aq lehtë tregohet i pabesë ndaj meje? Pse, atëherë, e shfrytëzon trajtesën time *Ideologjia e shpërbërjes* për të filluar një polemikë për çështje fetare, sado unë në trajtesën e përmendur merrem edhe me çështjen e gjuhës standarde dhe me përpjekjet për krijimin e identitetit kombëtar kosovar?

Sigurisht kishte një arsye, në të vërtetë një interes të veçantë vetjak për këtë.

SA MË LARG NGA E KALUARA KOMUNISTE

Ata që i kanë lexuar veprat publicistike të Ismail Kadaresë pas daljes në Francë, dhe ata që i kanë lexuar a dëgjuar intervistat dhe deklaratat e tij të ndryshme në këtë kohë, dhe ata që sadopak i kanë përcjellë paraqitjet e tij botore në Atdhe, në Evropë e në SHBA, ata nuk e kanë pasur të vështirë të binden se ai po bënte shumë përpjekje për të krijuar përfytyrim të ri për veten: një përfytyrim që, vetëkuptohet, do të ndryshonte plotësisht prej përfytyrimit që për të ishte krijuar në kohën e komunizmit. Dhe, këto përpjekje as nuk ishin të papritura, as nuk ishin shumë, shumë të

çuditshme. Një varg shkrimtarësh, nga vendet ish-komuniste, që kishin qenë pjesëtarë të nomenklaturave komuniste, që i kishin shërbyer përtokas komunizmit, që kishin qenë të privilegjuar si Ismail Kadare apo përafërsisht si Ismail Kadare nga udhëheqjet komuniste, do të bëjnë përpjekje që të lahen e të shpërlahen sa më fort prej së kaluarës së tyre! Por, përpjekjet e Ismail Kadaresë për të ikur sa më larg nga e kaluara e tij komuniste, do të jenë më origjinale dhe më të veçanta se të shumicës së bashkëmendimtarëve e të ngjashëmvepruesve të dikurshëm qoftë në vendet e tjera ish-komuniste, qoftë në Shqipëri.

Ndryshe prej shumë shkrimtarëve të tjerë oborrtarë të komunizmit, që do të përpiqen të krijojnë përfytyrim të ri për veten duke e kritikuar komunizmin, në radhë të parë, si ideologji dhe praktikë shtypëse mbi liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, mbi lirinë e krijimtarisë dhe lirinë e ndërgjegjes, Ismail Kadare do ta përqendrojë kritikën kundërkomuniste mbi njeriun që e kishte përkrahur, që e kishte mbrojtur, që e kishte afirmuar, që e kishte bërë të mundshëm përkthimin e veprave të tij të para në gjuhën franceze: Enver Hoxhën. Nuk mund të thuhet se Ismail Kadare nuk e dinte, se nuk kishte lexuar, se diktatorët nuk lindin diktatorë, por diktatorë i bëjnë, kryesisht, të tjerët: të ngjashmit me Ismail Kadarenë - ata që turren për t'u ngritur, për t'u shquar, për të përfutur sa më shpejt duke u servilizuar sundimtarëve. “Nuk qëndron problemi te Cezari që triumfon mbi të tjerët - shkruante filozofi bask Ortega Y Gasset - por te të tjerët që i bëjnë të mundur Cezarit të triumfojë”. Dhuna e diktaturës nuk është dhunë e bërë me duart e diktatorit, por dhunë e bërë me duart e atyre që në emrin e tij ushtrojnë dhunë: e vetjeve të etshme për pushtet - e frikacakëve, e servilëve, e mashtruesve të ndryshëm, e demagogëve të ndryshëm, e dhunëtarëve të ndryshëm. Diktatori, vërtet, krijon sistemin e dhunës, ngrihet në sajë të dhunës, por falangat e dhunëtarëve e mbajnë dhe e zbatojnë atë sistem.

Ismail Kadare e kishte kuptuar se kritika e tij e paskohshme kundërkomuniste, se kritika e tij e komunizmit pas varrosjes së komunizmit, mund të ishte e bindshme dhe, sidomos, përshtypjelënëse në qoftë se do të përqendrohej në Mitin e komunizmit shqiptar, në Zotin e komunizmit shqiptar – në Enver Hoxhën. Të kritikosh komunizmin pas varrimit të komunizmit – kjo ishte dukuri e përgjithshme, kjo ishte punë e thjeshtë, këtë e bënin të gjithë, madje edhe ata apo, sidomos, ata, që komunizmit i kishin shërbyer më së përlshmi në institucione të ndryshme të pushtetit dhe në fusha të ndryshme të jetës shoqërore; por të kritikonte komunizmin një shkrimtar me popullorësi të jashtëzakonshme në kohën e komunizmit, të kritikonte Mitin e komunizmit, Zotin e komunizmit, biri i tij shpirtëror, krenaria e tij letrare artistike dhe, pse jo, teorike ideologjike, siç konsiderohej atëherë Ismail Kadare - e kjo do të thoshte shumë më tepër se ç'mund të thoshin kritikantët e tjerëve, kjo kishte kuptim shumë më të madh, kjo kishte jehonë shumë më të gjerë, kjo ishte kritikë pambarimisht shumë përshtypjelënëse. Të kritikosh komunizmin, dhunën e tij, patologjinë e tij politike, ideologjike dhe, mbi të gjitha, praktike, përmes kritikës së Zotit të komunizmit dhe ta kritikosh duke zbuluar edhe të këqijat e supozuara intime të tij - e këtë mund ta bënte vetëm ai që kishte qenë i afërt me të, që kishte shkruar roman-apoteozë dhe apoteoza për të, e të cilit s'ka se si të mos i besohej.

Ikja e Ismail Kadesë prej së kaluarës komuniste dhe prej Zotit të komunizmit shqiptar, babait shpirtëror, Enver Hoxhës, sado jehuese, sado përshtypjelënëse nuk do të jetë e mjaftueshme për rehabilitimin, prandaj as për popullorësinë atje ku Ismail Kadare ishte i interesuar të depërtonte, të ishte i pranuar dhe i popullarizuar. Për këtë arsye Ismail Kadare do të kujdeset të gjejë edhe një temë tjetër për trajtim intelektual, për vetërrëfim të ndryshuar që do të jetë politikisht e koniunkturshme

dhe që do të zgjojë kureshtjen për të dhe për krijimtarinë e tij, që do t'ia çelë dyert e depërimit në tregun letrar.

Dhe, kjo temë do të quhet: feja.

QËNDRIMET KUNDËRMYSLIMANE

Shihej qartë se bota, fatkeqësisht, po hynte gjithnjë e më dukshëm në kohën e fërkimeve fetare, të cilat studiues të dukurive globale do t'i quajnë konflikt i qytetërimeve: i qytetërimit islamik dhe i qytetërimit të krishterë. Natyrisht, shkrimtari Ismail Kadare nuk mund të qëndronte pa thënë mendimin e tij për çështje fetare, sepse ai nuk kishte qëndruar kurrë asnjëherë, eunuk, ndaj problemeve më të mprehta të përtashësisë. Interesat e tij letrare dhe politike kërkonin që Ismail Kadare, kur drejtpërdrejt e kur ndërmjetësueshëm, t'i shprehte pikëpamjet e tij fetare. Dhe, ai do ta bëjë këtë si gjatë disa retushimeve më sipërfaqësore a më rrënjësore të disa veprave letrare, ashtu edhe në intervistat, në deklaratat dhe në veprat e ndryshme publicistike. Dhe, do ta bëjë këtë në fillim më kujdesshëm e me kalimin e kohës gjithnjë e më zëshëm. Nuk është e vështirë për të vërejtur se në ato retushime, shkrime publicistike, intervista e deklaratat ai nuk i trajton të barabarta dinjitetet e fesë myslimane dhe të fesë së krishterë. Në njërin anë duke folur shpërfillshëm apo, madje edhe fyeshëm ndaj fesë myslimane, ai do të bëhet propagandues gjithnjë e më i përkushtuar i fesë së krishterë në anën tjetër. Ndryshe prej shkrimtarit anglez me prejardhje pakistaneze, Salman Ruzhdi, i cili do të shkruajë romanin e shpallur kundërmysliman,

Vargjet satanike, për ç'shkak, mandej, do të jetë i shtrënguar t'i kalojë disa vite në "ilegalitetet", Ismail Kadare do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të shkruajë vepër të veçantë të tillë. Në qoftë se Salman Ruzhdiut nuk do të mund t'i afrohej me fuqinë krijuese, Ismail Kadare do t'ia kalojë atij me vigjilencë, e cila kohë pas kohe do t'i dobësohej deri në ditët tona. Qëndrimet e tij kundërmyslimane, ndërkaq, të shprehura, sidomos, në shtypin e huaj, përpos atyre të cilëve Ismail Kadare përpiquej t'u binte në sy, u kishin rënë në sy edhe lexuesve shqiptarë, prej të cilëve do të priten me keqardhje të veçantë. Do të bëhen edhe reagime. Një prej reagimeve të tilla do të botohet edhe në javoren e Prishtinës, *Zëri*, më 27 maj 1992. Në të, përpos të tjerash, thuhet:

“Qendrat Islame Shqiptaro-Amerikane në Shtetet e Bashkueme të Amerikës, mbajtën një takim në Xhaminë e Qendrës Islame Shqiptaro-Amerikane në Nju-Jork – Nju Xhersi, për të shqyrtue dhe diskutue bashkërisht, disa qëndrime tejet negative, sa absurde, aqë edhe indinjuese të shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare, të shprehun kobëve të fundit, si në vepra të tija ashtu edhe përmes të intervistave të tija në shtypin e jashtëm, dhe të cilat janë drejtue direkt kundër myslimanizmit.

Takimi i naltëpërmendun, nuk e kishte për qëllim, me i dalë në mbrojtje fesë islame, sepse atë e mbron kultura e vet mijëra vjeçare dhe themeli i saj që asht libri i shejtë: Kur’ani, meqë populli shqiptar i takon tri besimeve, ku ma se 70 % i takojnë besimit islam, dhe këto tri besime, nuk i kanë sjellë ndonji të keqe, por përkundrazi, gjithmonë mirëkuptim, harmoni dhe vëllaznim, dhe si konsequencë e gjithë kësaj, vijmë në përfundim, se shprehjet e pakontrollueme të shkrimtarit kriptokomunist Ismail Kadare, i cili islamizmin, të cilin po ta zëbërthejsb do të thotë PAQE, e krabason me ideologjinë komuniste, e cila nuk njeft as Zot, familje as traditë; dhe me bindje të plotë themi: se ky akt asht i drejtuemë në radhë të parë kundër krejt kombit shqiptar...

Tue qenë se, Ismail Kadare, në dukje i takon besimit islam, tubimi në fjalë, u distancua nga qëndrimet e padrejta dhe tejet të damshme për kombin shqiptar të Ismail Kadaresë, tue i kualifikue ato si të dëmshme, të padrejta, antinjerzore dhe antihumane, dhe për antishqiptare – të mos flasim”.

Nuk ka dyshim se krijimtaria e Ismail Kadaresë në kohën e komunizmit dhe krijimtaria e veprimtaria e tij pas rënies së komunizmit dëshmojnë se ai e kishte mësuar me kohë mësimin: një shkrimtar bëhet i rëndësishëm varësisht sa është politikisht i përdorshëm. Ai do të dijë të jetë politikisht i përdorshëm sot jo më pak se dje! Lobi shqiptar tashmë i krijuar për Ismail Kadarenë në Nju-Jork, dëshmon qartë se retushimet fetare të disa veprave të tij, paraqitjet kundërmyslimane dhe, sidomos, propagandimi i kthimit në fenë e të parëve i sjellin përkrahje dhe i premtojnë shkëlqime të reja emrit të tij: përkthime e çmime ndërkombëtare! Çmimi i pamerituar i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan ishte njëri prej tyre!

ESADIZMI

Në përgjigjen e tij *Pabesia e një polemisti*, Ismail Kadare i shmanget plotësisht diskutimit për çështjet që kishte ngritur në sprovën *Identiteti evropian i shqiptarëve*. Nuk jam i sigurt për cilën arsye më shumë i shmanget diskutimit: për shkak se nuk do të heqë dorë nga qëndrimet raciste ndaj Lindjes myslimane, ndaj qytetërimit mysliman, prandaj edhe ndaj fesë myslimane, apo për shkak se nuk do që për qëndrimet e tilla të shkruhet edhe një herë në gazeta.

Në qoftë se në përgjigjen *Pabesia e një polemisti* i është shmangur rrëshqitjes së sërishme në racizëm, nuk mund të thuhet se i ka shpëtuar rirrëshqitjes në myslimanofobi. Dëshmi për këtë është qëndrimi i tij ndaj Haxhi Qamilit – një figure fare skajore historike.

Nuk ka dyshim se ideologjia e Haxhit Qamilit, në qoftë se mund të flitet fare për një ideologji të tij, ishte e jashtëkohshme, prandaj edhe në shpërputhje me të përtashmen dhe të ardhmen e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar në përgjithësi. Por, gjithashtu, nuk ka dyshim se Ismail Kadare për arsye fetare e sheh qimen në syrin e Haxhi Qamilit, por nuk e sheh traun në sytë e disa figurave të tjera historike në të njëjtën kohë. Ai e tejzmadhon rebelimin e një njeriu, pa farë ndikimi të veçantë politik, kundër feudalëve, duke e njëjtësuar këtë rebelim me një ideologji pothuaj mosekzistuese filoturke. Nuk mund të besohet se prijësi i një kryengritjeje fshatare kundër feudalëve dhe kundër sundimit të të huajve, sidomos, serbëve e grekëve, në Shqipëri, nuk e dinte se në vitet 1914 - 1915 as nuk mund ta bënte Turqinë më sovranë të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, as nuk do të mund ta çonte Shqipërinë përtej Adriatikut e Mesdheut dhe ta bashkonte me Perandorinë e dikurshme Otomane. Shqipëria ishte shtet me kufij të caktuar ndërkombëtarisht, të njohur që nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe ajo ishte bërë shtet kur ishte çliruar nga Perandoria Otomane, që tashmë quhej e shkatërruar.

Për këtë arsye mund të thuhet se shumë më e rrezikshme për Shqipërinë shtet dhe për shqiptarët komb ishte politika tradhtare e Esad Pashë Toptanit, i cili në Luftën e Parë Ballkanike ua kishte lëshuar Shkodrën malazezve, kurse pas luftërave ballkanike kishte hyrë në marrëdhënie politike dhe ushtarake me Serbinë. Esad Pashë Toptani kishte shkuar dy herë në Nish në takime me kryeministrin e Serbisë, Nikolla Pashiq, dhe i kishte dërguar katërqind ushtarë shqiptarë, ithtarë të vet, në ushtrinë serbe, që po merrte pjesë në Luftën e Parë Botërore. Për shkak të politikës

separatiste dhe për shkak të pajtimit me pushtimin serb, Esad Pasha do të quhet tradhtar dhe për tradhti do të jetë i vrarë në Francë. Esad Pashë Toptani dhe Nikolla Pashiqi do ta ekzekutojnë Haxhi Qamilin jo për shkak të politikës së tij prej turkoshaku, po për shkak të mospajtimit të tij me politikën tradhtare të të parit dhe të mospajtimit me pushtimin e të dytit. E kjo domethënë se do ta ekzekutojnë si kryengritës shqiptar.

Ta gjykosh tani një kryengritës, qoftë edhe të pajisur me ide turkomane, për ide që s'mund të sillnin pasoja e të heshtësh tradhtinë e një separatisti që bashkëpunonte me pushtuesin e tokave shqiptare dhe, madje, të Shqipërisë shtet ky gjithsesi nuk mund të quhet atdhetarizëm shumë i kthjellët. Cila është më e durueshme: të trajtohesh tradhtar si Esad Toptani a kryengritës turkashak, por kundërserb, si Haxhi Qamili? Po të na dënonte Zoti të zgjidhnim dhunshëm, Ismail Kadare, pa dyshim, do të zgjidhte të parin. Dhe, le ta zgjedhë e le të jetë – esadist!

Lindjefobia e kjo domethënë myslimanofobia mund të konsiderohet arsye pse, përpos tradhtisë së Esad pashë Toptanit, Ismail Kadare e hesht edhe politikën, po ashtu, kundërhistorike, të dy figurave të tjera të asaj kohe po ashtu skajore historike: e hesht politikën e Marka Gjonit e të Preng Bibë Dodës. Në qoftë se Haxhi Qamili na qenka lektisur kot pas një pushtuesi të dëbuar, që në Shqipëri kurrë më nuk do të mund të sundonte, Marka Gjoni dhe Preng Bibë Doda i bënin dëm të dyfishtë Shqipërisë: në njërin anë bënin politikën e përkrahjes së pushtimit italian, kurse, në anën tjetër, bënin politikën separatiste të shpalljes së Mirditës autonomi - njëri i ledhatuar nga Beogradi e tjetri nga Cetina.

Gjykimi i një kryengritësi për një iluzion politik e lënia në heshtje e dy separatistëve, politikat e të cilëve mund të tregoheshin më të rrezikshme për Shqipërinë dhe për shqiptarët, gjithsesi nuk duket

gjykim i drejtë historik. Pas gjykimit të tillë, në njërën anë, dhe pas heshtjes së tillë, në anën tjetër, nuk është e vështirë të shihen motive ideologjike fetare.

REAGIMET NDAJ POLEMIKËS

Në gazetatat e Tiranës dhe në gazetatat e Prishtinës, deri sot kur po e shkruaj këtë përgjigje, janë botuar shumë reagime ndaj polemikës midis Ismail Kadaresë dhe meje. Numri më i madh i reagimeve në gazetatat e Prishtinës në të vërtetë janë reagime më parë të botuara në gazetatat e Tiranës.

Si historian i letërsisë shqipe nuk di shkrim që të ketë nxitur më shumë reagime se ç'ka nxitur përgjigja ime *Realiteti i shpërfillur* ndaj sprovës *Identiteti evropian i shqiptarëve* me të cilën Ismail Kadare i kishte kundërshtuar pikëpamjet e mia të paraqitura në kreun Identiteti kombëtar dhe vetëdija fetare të trajtesës *Ideologjia e shpërbërjes*. Le të thuhet se më i madh se numri i reaguesve që çështjet e ngritura në këtë polemikë kujdesen t'i trajtojnë objektivisht, pa paragjykime fetare, politike, partiake, ideologjike, pa anime miqësore e të tjera, është numri i reaguesve, të cilët nuk dëshmojnë se janë të liruar prej disa paragjykimeve të tilla apo prej animeve miqësore. Nuk është e vështirë për të vërejtur se paragjykimet dhe animet e tilla posaçërisht shprehen në shkrimet e disa gazetarëve, publicistëve dhe të disa miqve indigo të Ismail Kadaresë.

Ndër mediat që do të mbajnë qëndrim objektiv, mjerisht, nuk do të mund të radhitej pa sadopak ngurrim as gazeta *Tirana observer* dhe nuk do të mund të radhitej në radhë të parë për shkak të

pyetjes që do t'ua bëjë të ftuarve për deklarata në lidhje me polemikën: a mendoni se polemika e dëmton imazhin e shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare? Me të njëjtën arsye do të mund të bëhej pyetja: a mendoni se polemika e dëmton imazhin e shkrimtarit, historianit të letërsisë dhe intelektualit tonë të madh Rexhep Qosja? Shumë më normale, më frytdhënëse për kulturën e diskutimeve intelektuale e politike do të ishte pyetja, që përjashton gara e hierarki sportive: sa ndriçon çështjen e sa i kontribuon së vërtetës kjo polemikë?

Inkuadrimi i kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha, në këtë polemikë në anën e Ismail Kadaresë sikur i shpjegon këto paragjykime dhe anime të disa reaguesve. Partitë në pushtet, po e tregon edhe kjo polemikë, ende përcaktojnë politikën, etikën dhe estetikën e shumëve prej nesh, prandaj edhe të shumë gazetave dhe mediave elektronike.

Disa nga miqtë e Ismail Kadaresë, si edhe miku i tyre, në reagimet e botuara bëjnë përpjekje që t'i zhvlerësojnë pikëpamjet e mia - duke i shtrembëruar e duke i falsifikuar dhe që të më zhvlerësojnë mua - duke më fyer kur më butë e kur më vrazhdë se ai! Bëjnë përpjekje të krijojnë përshtypjen në opinion se kjo polemikë në të vërtetë është polemikë, siç thotë njëri prej tyre, midis një shkrimtari të madh, botëror, dhe një shkrimtari normal, domethënë, thotë ai, lokal! U mbeti pa thënë, si e tha njëri që s'i duartroket Ismail Kadaresë, se kjo në thelb është polemikë midis Goliatit dhe Davidit. Gjedhet mitologjike përsëriten! Bariu i vetmuar, Davidi, me një shkop në dorë dhe me llastik në brez, ka marrë guximin t'i kundërvihet Goliatit. Për të krijuar bindjen se kësaj radhe Goliati do të jetë ai që do ta mundë mendërisht dhe moralisht Davidin, miqtë e Ismail Kadaresë, bashkë me të, do të më bëjnë një portret të shëmtuar, të cilin do të donin ta shihnin gjithmonë në galerinë kombëtare të portreteve.

Çka do të thonë ata për mua?

TË GJITHË PORTRETISTËT E MI

Pavarësisht pse unë për ta kurrë s'kisha thënë fjalë portretizuese, ata do të thonë:
se unë jam një enverist, që e mundon nostalgjia për Enverin,
se unë jam Enver i Letrave,
se më mundon nostalgjia
edhe për Jugosllavinë
edhe Serbinë,
se jam njeri që kam ngritur një flamur të ri, të quajtur flamuri i myslimanizmit,
se unë jam gardian i Lindores,
se unë jam taliban,
se jam blasfemues i religjionit,
se po ndërtoj një politikë dhe një ideologji të re, së cilës do të shohin si do t'ia vënë emrin;
se jam hiç më pak se një delirant,

se kam ide fikse,
se hidhem në ekstreme,
se jam njeri me karakter autarkik,
se kam qejf të më quajnë baba i kombit dhe
bacë i dijes në Kosovë,
se të gjitha këto që po i shkruaj – i shkruaj për arsye se dëshiroj të më trajtojnë numër një e jo
numër dy në komb;
se në duel me një ish-kryetar në Kosovë
humba,
se në zgjedhjet lokale në Kosovë në vitin 2000
humba,
se në zgjedhjet e 3 korrikut në Shqipëri
humba,
Se jam halldup,
Se jam gërxho,
se jam një nga mbytësit e një idiome (të gegërishtes),

se jam ballabani i vonuar,
se jam nacionalist fundamentalist (ndoshta fundamentalist),
se jam një skriboman,
se po përpiqem të bëj perestrojkën tonë,
se jam një shkrimtar lokal, domethënë i njohur vetëm në Bregun e Diellit, në Prishtinë!
se jetoj me kompleks gjenerali,
se jam gjeneral i pamundësuar,
se jam kolos i lidhun!
Se duhet të më dëbojnë prej Kosovës!
Se, se, se, se, se...!

Portretizuesve të mi, të dhuruar me dhuntinë që të bëjnë portrete me epitete, që të fyejnë të tjerë, nuk do t'u përgjigjem në fyerjet dhe në falsifikimet e pikëpamjeve të mia. Do të merrem vetëm me çështjet, pavarësisht prej cilëve reagues janë të ngritura, diskutimin e të cilave e çmoj të nevojshëm. Kjo do të thotë se para se t'ia jap fjalën portretizuesit më të talentuar dhe, njëkohësisht, më të çmuar në artin tonë figurativ, kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha, do të flas edhe për disa shqetësime të reaguesve të tjerë ndaj polemikës.

VETËM E VËRTETA I BASHKON NJERËZIT

1. Disa nga reaguesit shprehin shqetësimin se polemika midis Ismail Kadaresë dhe meje do të shkaktojë ndarje mes intelektualëve shqiptarë, e ndoshta, edhe mes kosovarëve dhe shqiptarëve, si po na ndajnë ata që bëjnë përpjekje të kota të krijojnë identitetin kombëtar kosovar dhe një gjuhë tjetër, standarde për të. Edhe më i mprehtë është shqetësimi i atyre që thonë se kjo polemikë, në rastin më të keq, mund të shkaktojë ndarje fetare!

Është për nderim shqetësimi i këtyre reaguesve, por, disa të tjerë mendojnë se një shqetësim i tillë është i paarsyeshëm. Një polemikë, sado e ashpër dhe sado e shtrirë, nuk mund të krijojë ndarje, sepse polemikat, që sqarojnë çështjet, në thelb synojnë mënjanimin e ndarjeve. Ato edhe s'mund të bëhen si duhet midis njerëzve që, megjithatë, s'do të mund të merreshin vesh. Përvoja historike, kudo dhe kurdo, ka dëshmuar se ndikim të padëshiruar mund të ushtrojnë, në radhë të parë, problemet e fshehura, problemet kulturore, politike, morale, shoqërore, e të tjera që mbulohen me, ta themi, tepih politik. Nuk e thotë populli i urtë kot: plaga që fshihet nuk shërohet. Sqarimi i problemeve më parë se ç'i ndan, i afron njerëzit. Nuk e them unë i pari se njerëzit përherë bashkohen vetëm rreth të Vërtetës dhe të Drejtës. Rreth mashtrimeve, gënjeshtrave, kodeve të rrejshme, njerëzit mund të bashkohen vetëm përkohësisht - derisa të mos i shohin e të mos i kuptojnë.

Dukshmëria (transparenca) nuk është kot nocion aq i çmuar në vendet me tradita më të gjata demokratike. Meqenëse e kanë shijuar gjatë dobishmërinë e saj, ato vende jo rastësisht po kërkojnë që ta zbatojmë edhe ne.

KU E LAMË KOSOVËN?

2. Është e çuditshme dhe, njëkohësisht, treguese pse si një numër i reaguesve, kur flasin për identitetin shqiptar, kanë parasysh vetëm Shqipërinë. Për këtë arsye emërvendi Shqipëri bëhet zëvendësim për emërnjeriun shqiptar. I pari që e bëri këtë është Ismail Kadare kur, duke folur për identitetin e shqiptarëve në sprovën *Identiteti evropian i shqiptarëve*, thotë atë fjalinë e papranueshme: “Letrat e Shqipërisë janë të qarta”! Nuk ka dyshim se kjo është një pikënisje e gabuar për çdo gjykim për identitetin e shqiptarëve. Nuk mund të gjykohet shkencërisht për çështje të identitetit shqiptar duke pasur parasysh vetëm Shqipërinë, domethënë duke mos pasur parasysh të gjithë shqiptarët në Ballkan dhe shqiptarët në diasporë. Gjykimi për pjesën nuk mund të zëvendësojë gjykimin për tërësinë. Pjesa, sado e madhe dhe sado e rëndësishme qoftë, nuk është tërësia. Ata që për identitetin e shqiptarëve do të gjykojnë duke pasur parasysh të gjitha trevat shqiptare e jo vetëm Shqipërinë shtetërore, të gjithë shqiptarët e jo vetëm ata që jetojnë në Shqipërinë shtetërore, nuk do t’i lejojnë vetes që të shpërfillin përbërësit e shumtë të kulturës e të qytetërimit mysliman në identitetin e gjithësishtë, të përbashkët, historik të shqiptarëve. Pikënisja metodologjike e Ismail Kadaresë, e formuluar në fjalinë përjashtuese ndaj Kosovës “Letrat e Shqipërisë janë të qarta” si edhe e miqve të tij reagues ndaj kësaj polemike, vetëm sa i frymëzon përpjekjet e disa vetjeve, disa grupeve dhe ndonjë institucioni në Kosovë për krijimin e identitetit kombëtar kosovar. E shqiptarët në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Luginën e Preshevës dhe kudo qofshin sot vetëm së bashku përbëjnë identitetin e përbashkët, të përbërë, të gjithësishtë shqiptar. Për identitetin kombëtar shqiptar si për një identitet të përbashkët, të gjithësishtë, historik mund të flasim vetëm kur t’i marrim parasysh të veçantat e shqiptarëve të

krahinave të ndryshme, të dialekteve të ndryshme, të feve të ndryshme dhe të politikave e të fateve të ndryshme historike shqiptare, sidomos prej copëtimit të trojeve shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1912 - 1913.

BESIMI DHE MOSBESIMI

3. Ka nga reaguesit që e quajnë të papranueshëm konstatimin tim mbi rëndësinë e përbërësit fetar (mysliman) në identitetin e përgjithshëm, historik, shqiptar. Qëndrimin e tyre të tillë e mbështesin në konstatimin se qenkemi populli më mosbesimtar në Evropë, me ç'rast pohimi më mosbesimtar tingëllon këtu si vlerësim pozitiv. Në qoftë se, sipas konstatimit të këtyre reaguesve, ne, vërtet, qenkemi populli më mosbesimtar në Evropë - më mosbesimtar se popujt me tradita më të gjata shtetërore e demokratike dhe me tradita më të pasura kulturore, mos do të thotë kjo se ne qenkemi populli më i përparuar, më i zhvilluar, më i kulturuar i Evropës? Le ta japin ata vetë përgjigjen për këtë pyetje, kurse unë po shtoj: ndoshta në kohën e komunizmit edhe mund të radhiteshim ndër popujt, si i quajnë ata, më mosbesimtarë të Evropës, por nuk jam aspak i sigurt se sot jemi aq mosbesimtarë sa dje. Dëshmi për shtimin e përkushtimeve fetare të pjesëtarëve të të tri feve mund të shihen e mund të dëgjohen kudo: në familje, në kisha e në xhami, në hapësirat para tyre, në shkolla e në fakultete, në institucione të shkencës, të kulturës e, madje, të politikës. Ata që i shpallin shqiptarët popullin më mosbesimtar në Evropë sot, mund të mos besojnë, ndoshta, në qoftë se u thuhet: në institucione shkencore në Prishtinë, për shembull, para, ta themi, njëzet vjetësh nuk dihej nëse e agjëronte kush ramazanin, kurse sot këtë e bëjnë jo pak prej tyre, përpos të tjerësh, edhe këshilltarë shkencorë; në shkollat e mesme në Kosovë, para

njëzet vjetësh, ta themi, nuk dihej nëse agjëronte ndonjë nxënës a ndonjë mësues, arsimtar a profesor, kurse sot dihet për shumë e shumë prej tyre; në xhamitë e Kosovës para njëzet vjetësh nuk dihej nëse shkonte të falej ndonjë profesor fakulteti, kurse sot është gjithnjë e më i dukshëm numri i tyre që të premteve shihen në xhami. Në Kosovë sot me rituale fetare varrosen edhe anëtarë të ndjerë të Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës; por, në Kosovë sot me rituale fetare ngjet të varrosen edhe ish-funksionarë të lartë, madje, edhe më të lartit, të Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës. Si në Kosovë, përkushtimet fetare mbas rënies së komunizmit janë shtuar edhe ndër shqiptarët në Maqedoni, në Luginën e Preshevës dhe në Mal të Zi. Të mos i shohësh këto sot do të thotë të mos e shohësh njëmendësinë. Dhe, të shpërfillësh përbërësit e besimit mysliman, - që në Kosovë e në Shqipëri kanë ardhur nga Lindja turko-arabe - e kjo do të thotë edhe të kulturës me bazë besimin mysliman në identitetin e gjithësishtëm shqiptar, do të thotë të shpërfillësh njëmendësinë: të shpërfillësh njëmendësinë qoftë pse nuk je në gjendje ta shohësh, qoftë - çka, mjerisht, ngjet më shpesh - pse nuk dëshiron ta shohësh të tillë çfarë është ajo. E kur flitet për identitetin e shqiptarëve në përgjithësi e jo vetëm për identitetin e shqiptarëve në Shqipërinë shtetërore do të duhej të dihej se në Kosovë, në Maqedoni, në Luginën e Preshevës dhe në Mal të Zi, jetojnë sot gati gjysma e shqiptarëve në Ballkan, kurse mbi 95 për qind e këtyre shqiptarëve i takojnë besimit mysliman.

Besimin e autorëve të pohimit se shqiptarët na qenkan populli më mosbesimtar në Evropë e përgënjeshtrojnë edhe të dhëna të tjera ndër të cilat mund të përmendet një emision i udhëhequr prej Alban Dudushit në *Top Channel*, në të cilin, përpos se u theksua racizmi i Ismail Kadaresë, u paraqitën të dhëna për rënien e numrit të martesave të përziera e për shtimin e numrit të konflikteve fetare dhe këto të dhëna flasin, ndoshta, për forcimin, apo, madje, për tejshquarjen e vetëdijes fetare në jetën tonë.

4. Njëri prej reaguesve do të ma marrë për të keq se për njëren prej çështjeve për të cilën është folur në përgjigjen ndaj sprovës së Ismail Kadaresë paskam folur si myftiu i një qyteti tonë. Dhe, kjo se paskam folur ashtu siç paska folur edhe myftiu, nuk e di nëse fola unë përpara tij apo ai përpara meje, qenka e palejueshme. Mos do të thotë kjo se një intelektual për asnjë çështje nuk do të duhej të fliste siç flet një myfti? Dhe, mos do të thotë kjo se çdo gjë që thotë një myfti që përpara qenka e papranueshme? Nuk e di nëse shqiptuesit të këtij pohimi i shkon mendja se vetëm në kohën e komunizmit ishte e padëshiruar, madje, e palejuar që të thuash *diçka* që do të pajtohej me atë që për atë *diçka* e paska thënë një myfti, një kardinal a një rabin!

Nuk e di si mund të kuptohet më parë ky qortim: si paragjykim fetar, si myslimanofobi, apo si një klishe komuniste e strehuar në ndërdijen e qortuesit. Pak më e vrazhdë, ndoshta, do të mund të quhej këshilla e reaguesit tjetër, i cili shqiptarëve që mund të mos mendojnë si ai ua tregon udhën e pelegrinazhit, për të zgjidhur, si thotë, brengat e veta! A bash kështu duhet të flasë një shqiptar ortodoks për shqiptarin mysliman që për haxhillëk shkon në Qabe apo një shqiptar mysliman për vëllanë ortodoks që për pelegrinazh shkon në Patrikanën e Stambollit e për vëllanë katolik që për pelegrinazh shkon në Vatikan?!

KRAHASIME QË S'BËHEN

5. Një reagues tjetër pa ndonjë ngurrim dhe pa ndonjë hamendësim shpërfill kritikën letrare, teorinë letrare dhe historinë letrare e kjo domethënë shkencën e letërsisë në krahasim me letërsinë. Ç'më duhet mua, mendon ai, studimi i veprës së një shkrimtari kur e kam atë vepër?

Ç'më duhet mua, thotë ai pa ngurrim, monografia e Rexhep Qosjes për Naim Frashërin? Dhe, unë nuk e di a nuk i duhet kjo monografi pse e paska shkruar Rexhep Qosja apo pse qenka e shkruar mbi krijimtarinë e Naim Frashërit? Ky pohim shqiptohet për t'u dëshmuar pohimet e disa miqve të Ismail Kadarese e, pastaj, edhe mendimi i kryeministrit të Shqipërisë, se polemika ndaj së cilës reagojnë ata është politikë midis dy autorëve me popullorësi të ndryshme: një shkrimtari, një poeti - botëror dhe një kritik, një historiani letrar - lokal! Ta lëmë krahasimin midis popullorësive e të merremi me krahasimin vlerësues midis fushave krijuese: midis poezisë dhe shkencës, midis poezisë dhe trajtave të tjera të veprimtarisë mendore të njeriut.

Krahasimet vlerësuese midis arteve të veçanta dhe midis arteve e trajtave të tjera të veprimtarisë mendore të njeriut, siç janë shkenca dhe filozofia, quhen të tejkaluara, të papranuara, të gabuara, sepse të gjitha artet, të gjitha shkencat dhe filozofia i duhen njeriut, janë shprehje e mendësive të tij dhe i shërbejnë jetës së tij. I takon një kohe të shkuar koncepti romantik sipas të cilit poezia dhe muzika përfaqësojnë dëshminë më të fuqishme të gjeniut ashtu siç i takon një kohe të shkuar koncepti hegelian sipas të cilit poezia (e kjo domethënë letërsia) i takon fëmijërisë, kurse filozofia dhe shkenca pjekurisë së njerëzimit. Për këtë arsye në kulturat e zhvilluara nuk bëhen krahasime vlerësuese midis shkrimtarit dhe kritikut, midis shkrimtarit dhe shkencëtarit, midis shkrimtarit dhe filozofit.

Studiuesi i njohur polak, Henrik Markieviç, thotë, fjala vjen, se sot “gjithnjë e më dukshëm po hiqen kufijtë midis letërsisë dhe filozofisë, shkencës, reportazhit ose publicistikës”; studiuesi francez, Robert Eskarpi, thotë se ka shumë vepra të shkruara me qëllim funksional që çmohen si vepra të vërteta letrare; teoriku i njohur i letërsisë, Cvetan Todorov, në trajtesën *Nocioni i letërsisë*, fjala vjen, thotë se “çdo tip i ligjërimit që zakonisht e quajmë letrar e ka tipin e ngjashëm jo letrar

me të cilin është më i afërt se me një tip tjetër të ligjërit letrar”. Krijuesit e ndryshëm të arteve, të shkencës dhe të filozofisë çmohen jo varësisht pse njëri është poet, tjetri shkencëtar e i treti filozof, po varësisht prej vlerës, kuptimit, rëndësisë së veprave të tyre. Cili intelektual francez do të thoshte, fjala vjen, se Rasini, Kornej a Molieri janë më të çmuar në kulturën franceze se Dekarti? Asnjëri. Cili intelektual francez do të thoshte se Lamartini është më i çmuar e më i rëndësishëm për kulturën franceze sesa Rusoi? Asnjëri. Cili intelektual francez do të thoshte se Pol Valeri në kulturën franceze është më i çmuar e më i rëndësishëm se Henri Bergsoni apo Gustav Lanson? Asnjëri. Cili intelektual gjerman do të thoshte se Gëte dhe Shileri për kulturën gjermane janë më të rëndësishëm se Kanti dhe Hegeli? Asnjëri.

Në letërsinë italiane të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe të shekullit njëzet kanë krijuar me mijëra poetë, prozatorë e dramaturgë, por ndër, të themi, pesë shkrimtarët më të lavdishëm të shekullit nëntëmbëdhjetë hyn kritiku dhe historiani i letërsisë italiane, Francesko de Sanktis, kurse ndër më të lavdishmit e shekullit njëzet hyn kritiku dhe esteti Benedeto Kroçe. Albert Kamy dhe Zhan-Pol Satri janë dy nga figurat më të mëdha të letërsisë franceze të shekullit njëzet, por janë aq të mëdhenj, aq të çmuar e aq të rëndësishëm në këtë letërsi dhe në letërsinë botërore në përgjithësi, jo vetëm si prozatorë, por edhe si filozofë, kritikë, eseistë, intelektualë me formim dhe ndikim universal - Satri dhe jo vetëm si prozator e dramaturg, po edhe si mendimtar, kritik, intelektual i gjithanshëm - Kamy.

Ç’përfaqësojnë mijëra e mijëra romancierë në krahasim me Herodotin, Plutarkun, Livin, Tacitin, Erazmon, Bekonin, Montenjnin, Lesingun, Vikon, Volterin, Didronë, Renanin, Tenin, të cilët trajtohen shkrimtarë të mëdhenj sepse janë, para së gjithash shkencëtarë, mendimtarë, moralistë të mëdhenj?

Krahasimet vlerësuese midis intelektualëve tanë, midis krijuesve tanë, varësisht prej fushës krijuese me të cilën merren, nuk e tregojnë të vërtetën për rëndësinë dhe për rolin e tyre të përgjithshëm në letërsinë dhe në kulturën kombëtare.

SOVJETIZIMI DHE EVROPIANIZIMI

6. Disa prej reaguesve - ithtarë të Ismail Kadaresë, - nuk ngurrojnë që në reagimet e tyre të më mbajnë ligjërata për evropianizimin e letërsisë shqipe, duke i treguar me gishtin tregues evropianizuesit dhe kundërevropianizuesit e saj, duke e bërë Ismail Kadarenë evropianizues e mua kundërshtar të këtij evropianizmi. Janë turrur të marrin një flamur që s'iu takon, ndërsa Ismail Kadarenë si shumë herë dhe për shumëçka e vënë përpara! E ai, për t'u treguar çka s'ishte e pështyn edhe njërin nga mësuesit e tij të dikurshëm: Çernishevskin.

Ç'mund të thuhet për këto pohime dhe për këto krahasime?

Mund të thuhet: mbi tridhjetë e pesë vjet i ka kaluar Ismail Kadare duke e sovjetizuar jo vetëm me poezi e me prozë, po edhe me shkrime kritike dhe “teorike” letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Përmasat e vërteta të kësaj dukurie në krijimtarinë e tij mund të shihen në gjithë shtrirjen e saj vetëm kur të studiohet ajo.

E sovjetizimi dhe evropianizimi janë koncepte të papërputhshme, madje, të papajtueshme. E sovjetizimi dhe evropianizimi janë praktika letrare, artistike dhe kulturore në përgjithësi, të

ndryshme, të papërputhshme dhe të papajtueshme. Shkrimin e fundit apo, ndoshta, të fundit teorik dhe historiko-letrar, me të cilin i kontribuohet sovjetizimit të letërsisë shqipe, të shkencës letrare dhe të kulturës shqiptare, Ismail Kadare do ta shkruajë në çastet kur po dëgjoheshin grahmat e fundit politike, ideologjike dhe sistemore të komunizmit në Evropë dhe po fillonte çsovjetizimi i letërsisë dhe i kulturës shqiptare: në vitin kur po shënohej dyzetepesëvjetori i Çlirimit. Ishte kjo fjala teorike dhe historiko-letrare e Ismail Kadaresë mbi amshimin e realizmit socialist, e paraqitur në Konferencën Shkencore *Koba jonë, letërsia, shkencë letrare* në njërën nga sallat e Pallatit të Kongreseve më 13 nëntor 1989, që do të botohet mandej në numrin e janarit 1990 të revistës *Nëntori*. Ishte kjo fjala teorike dhe historiko-letrare e Ismail Kadaresë me të cilën ai zhvlerësonte të ashtuquajturën letërsi dekadente, mikroborgjeze, domethënë evropiane, me të cilën e shpallte të përjetshme letërsinë e realizmit socialist dhe me të cilën e madhëronte edhe njëherë rëndësinë e vijës së Partisë për letërsinë dhe artet. Në Evropë nuk kishte krijues, nuk kishte intelektual, që nuk shihte se në arkivolin e komunizmit po nguleshin gozhdët e fundit kurse Ismail Kadare i shkruante himn për pavdekësinë! Në letërsinë shqipe kurrë një poet s'ishte treguar më kundërprofet. Fatmirësisht një numër i prozave dhe i poezive të Ismail Kadaresë nuk e dëshmojnë teorinë e tij me të cilën propagandohej sovjetizimi i mëtejshëm i letërsisë dhe i kulturës shqiptare. Dhe, fatmirësisht, krijimtaria e tij letrare dhe publicistike pas rënies së komunizmit është krijuar në kundërshtim me atë teori. Por, pesëmbëdhjetë vjet vetëdije për nevojën e evropianizimit nuk janë shpagim i mjaftueshëm për mbi tridhjetë e pesë vjet teori dhe propagandë për sovjetizimin e letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Në vitet kur Ismail Kadare bënte sovjetizimin teorik dhe, në një pjesë të madhe, praktik të letërsisë shqipe, unë bëja shumë përpjekje për evropianizimin e saj: evropianizimin e gjithanshëm të saj. Dhe,

kjo dëshmohej jo vetëm në referencat e përdorura në veprat e mia për letërsinë shqipe. Dhe, kjo dëshmohej në indeksat e emrave në veprat e mia për letërsinë shqipe dhe për kulturën shqiptare. Mbi 95 për qind e emrave të shkrimtarëve, të krijuesve të tjerë të arteve të tjera, të filozofëve, të shkencëtarëve në veprat e mia janë emra shkrimtarësh, krijuesish të arteve të tjera, filozofësh dhe shkencëtarësh evropianë - francezë, gjermanë, anglezë, italianë, spanjollë, holandezë dhe amerikanë. Dhe, kjo dëshmohej edhe me pikëpamjet teorike në sprovën time *Letërsia kombëtare dhe letërsia botërore ose afrimi përmes ndryshimeve*, të botuar në vitin 1972. Dhe, kjo dëshmohej edhe me koncepte teorike në veprën *Tri mënyra të shkrimit shqip*, të shkruar në fund të viteve shtatëdhjetë, në të cilën politizimi dhe ideologjizimi, domethënë sovjetizimi, që predikonte e zbatonte Ismail Kadare në njërin anë, kurse folklorizimi, në anën tjetër, trajtohen si pengesa për evropianizimin e letërsisë, të arteve, të dijeve, të kulturës sonë në përgjithësi e kjo domethënë si pengesë e evropianizimit të identitetit tonë. Të thuash, prandaj, ç'është Ismail Kadare për veten dhe ç'është magnetofonat e tij për rolin tim dhe rolin e tij në evropianizimin a çevropianizimin e letërsisë dhe të kulturës sonë do të thotë të mos e shohësh të vërtetën, të mos e pranosh të vërtetën dhe të mos barazosh të pabarazueshmit siç do të thotë njëri prej magnetofonave të tij.

SI PO ZGJIDHET ÇËSHTJA KOMBËTARE

7. Një numër i reaguesve, megjithëse i vogël, i quajnë të jashtëkohshme e kjo domethënë anakronike diskutimet për çështje që po diskutohen në këtë polemikë e në reagimet ndaj saj dhe i quajnë kështu të jashtëkohshme, domethënë anakronike, sepse u tingëllojnë shumë kombëtare.

Në kohën e globalizmit, që, mendojnë, u sjell vetëm të mira kombeve, preokupimet kombëtare, thonë, të largojnë prej qëllimit kryesor, që është zhvillimi ekonomik dhe ngritja e mirëqenies së qytetarëve. Nuk janë këto, natyrisht, deklaratimet e para, as të vetmet në disa nga mediat tona në Prishtinë dhe në Tiranë, në të cilat ideja kombëtare quhet tashmë ide e tejkaluar. Harrohet se, siç po shihet në të gjitha anët e planetit, kombi është edhe më tej ajo forca, e cila, si e thoshte De Goli, e lëviz historinë. Popuj të mëdhenj nuk janë më pak nacionalistë se popuj të vegjël, që ende s'kanë zgjidhur as çështjen kombëtare, as çështjen demokratike. Dhe, harrohet se autorë perëndimorë, evropianë dhe amerikanë, në vendet e të cilëve globalizmi predikohet më së shumti, thonë se: 1. kapitalizmi me tregun e lirë, 2. të drejtat e njeriut me demokracinë liberale sekulare, dhe 3. shteti kombëtar përfaqësojnë tri parimet mbi të cilat qëndrojnë e sotmja dhe e ardhmja e Perëndimit dhe e njerëzimit. Dhe, harrohet se ne, si komb, ende nuk e kemi zgjidhur çështjen kombëtare dhe, si duken punët, nuk do ta zgjidhim përfundimisht as në këtë cikël historik. Është e vërtetë se pozita e shqiptarëve në Maqedoni, në Serbinë Jugore dhe në Mal të Zi sadopak po përmirësohet dhe është e vërtetë se Kosovës do t'i njihet pavarësia me ose pa farë kufizimesh, por është e vërtetë se shqiptarët mbesin të ndarë, siç ishin, në pesë shtete! E ashtu i copëtuat si shqiptarët nuk është asnjë popull evropian. Bashkësia ndërkombëtare nuk ua ka paracaktuar disa kufizime bisedimeve mbi statusin e Kosovës për hir të shqiptarëve, po, në radhë të parë, për hir të serbëve. Vullneti i, të themi, 10 për qind të serbëve të Kosovës vihet kështu mbi vullnetin e 90 për qind të shqiptarëve dhe të tjerëve në Kosovë. Sikur të mos favorizohej vullneti i serbëve, shqiptarëve të Kosovës do t'u njihet e drejta e popullit të ndarë dhunshëm prej shumicës së tij: e drejta e bashkimit me Shqipërinë.

E, sa rëndësi të madhe do të kishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë edhe për Kosovën, edhe për Shqipërinë, ndoshta, vetëm tani po shihet plotësisht. Përpara mendoja se duke u bashkuar me Shqipërinë do të shpëtonim njëherë e përgjithmonë prej Serbisë. Tani mendoj, ndërkaq, se duke u bashkuar me Shqipërinë, njëkohësisht, do të shpëtohej Kosova prej Kosovës dhe Shqipëria prej Shqipërisë. Domethënë: bashkimi do të kishte rëndësi jo vetëm ekzistenciale, ekonomike e politike, po edhe shoqërore, intelektuale dhe morale. Vetëm të bashkuar shqiptarët do të bëheshin çka mund të jenë, çka s'do të duhej të jenë dhe çka do të duhej të jenë edhe në pikëpamje shoqërore, edhe në pikëpamje të shëndetit moral.

Për këtë arsye jo diskutimet intelektuale për çështje kombëtare, pra edhe për identitetin, po mohimet e nevojës për diskutime të tilla mbi çështje kombëtare mund të quhen të jashtëkohshme dhe të jashtëvendshme.

KATEGORI E NDRYSHUESHME

8. Disa nga reaguesit, madje edhe nga reaguesit që nuk mbajnë anën e asnjërit polemist, thonë se që të dy polemistët e trajtojnë identitetin si diçka të ngurtë, të ndërtuar njëherë e përgjithmonë, domethënë të pandryshuar. Në shkrimet e mia *Ideologjia e shpërbërjes dhe Realiteti i shpërfillur* nuk shikohet ashtu identiteti i asnjë populli. Siç shihet prej sprovës *Identiteti evropian i shqiptarëve* dhe siç thuhet për të edhe në përgjigjen time *Realiteti i shpërfillur*, ashtu e shikon identitetin Ismail Kadare. Unë, përkundrazi, e trajtoj si kategori historike, dinamike, domethënë të ndryshueshme. Në

përgjigjen *Realiteti i shpërfillur* nuk e kam quajtur të arsyeshme, prandaj as të nevojshme, të përsëris disa pohime themelore për çështje të identitetit. Kam supozuar se lexuesi që e përcjell këtë polemikë e aq më parë lexuesi, që reagon ndaj saj, do të ketë lexuar jo vetëm sprovën e Ismail Kadaresë, *Identiteti evropian i shqiptarëve*, me të cilën e fillon këtë polemikë, por edhe trajtesën time *Ideologjia e shpërbërjes*, kreut të së cilës mbi identitetin kombëtar dhe vetëdijen fetare ai i është kundërvënë me atë sprovë. E në atë trajtesë, përpos të tjerash, unë them: “Identiteti i një populli është kategori historike: në procesin historik ai vjen duke u pasuruar apo, madje, duke u varfëruar dhe, rrjedhimisht, më pak a më shumë duke ndryshuar. Në procesin historik identitetet e kombeve marrin dhe japin, sepse fatmirësisht marrin dhe japin kulturat e tyre, qytetërimet e tyre në takim e dialog me kultura e qytetërimet të kombeve të tjera”. Populli shqiptar, them, është popull i kontinentit evropian, por popull i kontinentit evropian që ka bërë shtëpinë në atë pjesë të kontinentit, ku janë takuar pushtues të nisur nga Perëndimi në Lindje dhe pushtues të nisur nga Lindja në Perëndim, ku janë takuar e gërshetuar kultura dhe qytetërimi antik grek dhe romak, bizantin dhe latin, feja e krishterë dhe feja myslimane, kultura dhe qytetërimi evropian dhe kultura dhe qytetërimi islamik. Meqenëse populli shqiptar për rreth 500 vjet ishte i sunduar prej Perandorisë Otomane është e kuptueshme të thuhet se historia e tij për 500 vjet ishte histori e lidhur, para së gjithash, me historinë e kësaj Perandorie. Gjatë kësaj historie një përqindje shumë e madhe e popullit shqiptar kishte pranuar fenë e sunduesit dhe, duke përvetësuar fenë, kishte pranuar shumë, shumë përbërës shpirtërore dhe materialë të kulturës dhe të qytetërimit të tij: kultura dhe qytetërimi janë përcaktues tepër të rëndësishëm të identitetit të popujve. Të mohosh këto të vërteta do të thotë të mos shohësh dhe të mos pranosh të vërtetën, po të bësh propagandë politike kush e di përse dhe kushedi për kënd. Krahasimi i shqiptarëve me spanjollët prandaj, siç bën Ismail Kadare, është plotësisht i paqëlluar pikërisht për arsye se spanjollët nuk

janë islamizuar dhe, për arsye se nuk janë islamizuar, lidhjet e kulturës dhe të qytetërimit të tyre me kulturën dhe me qytetërimin arab janë fare të pakta dhe fare sipërfaqësore.

LETRARËSIA DHE PAVARËSIA?

9. Njëri ndër reaguesit e parë në polemikën midis Ismail Kadaresë dhe meje do të thotë, ndoshta për të thënë se sa e paktë, e parëndësishme është vepra ime kritike, eseistike, historike-letrare, letrare në krahasim me atë të Ismail Kadaresë se që prej vitit 1980 nuk merrem me kritikë e me krijimtari letrare e shkencore! Kritika e literaritetit, thotë ai, që ka filluar të zhvillohet përafërsisht në atë kohë, më ka nxjerrë prej radhëve të kritikëve dhe, në përgjithësi, të studiuesve të letërsisë shqipe dhe të krijimtarisë letrare. Meqë isha marrë me studime sociologjike letrare, thotë ai, nuk do të jem në gjendje t'u bashkohem radhëve të letrarësiologëve!

Harron të thotë ai, ndërkaq, se letrarësinë unë i thoja *vlerë estetike* dhe me studimin e vlerave estetike të letërsisë shqipe isha marrë para se vlerat estetike të pagëzoheshin letrarësi!

Pohimi i këtillë pjell përfundimin se veprat e mia *Nocione të reja albanologjike*, botuar më 1983, *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi*, në tri vëllime, botuar më 1984 - 1986, *Porosia e madhe* (monografi për Naim Frashërin), e botuar në vitin 1986 e të tjera, të botuara pas vitit 1980, pra, pas atij viti kur kritika mbi letrarësinë më paska nxjerrë nga studimi i letërsisë shqipe, i paska shkruar kloni i Rexhep Qosjes! Në qoftë se ky reagues ndaj polemikës midis Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qosjes nuk arrin ta përcaktojë as përafërsisht me saktësi vitin kur qenkam bërë hallall me letërsinë, me kritikën, me eseistikën dhe me

studimin historik të letërsisë, (sado do të mund ta bënte këtë po të shikonte kronologjinë e veprave të mia që e boton rregullisht Shtëpia botuese TOENA në kopertinat e botimeve të Rexhep Qosjes), ai thotë të vërtetën kur pohon se pas atij viti unë, vërtet, kam filluar të merrem shumë me shkrime politike, me publicistikë dhe me politikë. Në vend se letrarësisë, vërtet, u jam kushtuar shkrimeve politike dhe publicistike gjithnjë duke besuar se këto shkrime nuk do të jenë një punë e kotë. Më ishte mbushur mendja se shumë më të rëndësishme se një varg shkrimesh apo, madje, veprash për letrarësinë e, sidomos, për letrarësinë e veprave që kanë pak letrarësi, do të jenë pavarësia e Kosovës dhe demokracia e Shqipërisë dhe e Kosovës. Më ishte mbushur mendja, oh sa gabueshëm, se, si e thonë teorikë dhe estetë bashkëkohorë, edhe publicistika mund të ketë vlera letrare, kur e kur më shumë, madje, se disa vjersha, drama, tregime a romane.

E pse më ishte mbushur mendja se më e rëndësishme se të merresha me studime të letërsisë e të bëhesha “letrarësiolog”, ishte të merresha me shkrime politike dhe publicistike?

Dhuna gjithnjë e më e madhe dhe gjithnjë e më e përshtirë e Serbisë dhe e Jugosllavisë mbi popullin shqiptar në Kosovë, në Maqedoni dhe kudo jetonin pjesëtarë të tij në republikat ish-jugosllave; shkrimet gjithnjë e më të shumta të shkrimtarëve e të intelektualëve të tjerë serbë, maqedonas e, kur e kur malazez, kundër shqiptarëve, në të cilat aq shumë shtrembërohej, falsifikoheshin e vërteta për historinë dhe kulturën shqiptare, me të cilat në të vërtetë nënçmoheshin historia dhe kultura shqiptare, interesi historik për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe të çështjes shqiptare në tërësi, ideali i çlirimit nga sovraniteti sllav – të gjitha këto do të më shtynë që të mos u bashkohesha letrarësiologëve, të lija përkohësisht kritikën letrare, historinë e letërsisë, dramën dhe prozën e t’u kushtohem shkrimeve politike dhe publicistikës! Fryt i parë i kësaj pune publicistike do të jetë vepra *Populli i ndaluar*, në të cilën ishte përmbledhur pjesa më e madhe e shkrimeve në të cilat i kundërqendroja politikës serbo-

jugosllave ndaj shqiptarëve, në të cilat tregoheshin të gjitha llojet e dhunës shtetërore ndaj shqiptarëve, në të cilat çmaskohej shovinizmi intelektual serbo-maqedonas ndaj shqiptarëve dhe, njëkohësisht, tregohej se çka, dëshironin shqiptarët, si e shihnin ardhmërinë e tyre ata. Dhe, sidomos, çka pashmangshëm, iu takon si e drejtë natyrore dhe historike atyre. Dhe, këtë vepër do të detyrohem ta botoj në Zagreb, sepse jugosllavistët tanë nuk kishin lejuar të botohej në Kosovë.

Po, me shkrime politike e publicistike do të shtrëngohem të merrem edhe më tutje.

Përpos kundër dhunës shtetërore serbe e maqedonase, përpos kundër ideologjisë kundërshtiptare që predikonin intelektualë serbë, maqedonas e malazez, do të shtrëngohem të shkruaj edhe kundër politikës së atyre partive tona që thoshin se po ndërtojnë rend demokratik nën dhunën serbe.

Dhe, jo vetëm kaq.

Do të shtrëngohem të shkruaj edhe kundër politikës së kryetarit të atëhershëm të Shqipërisë, Sali Berisha, i cili të drejtat e shqiptarëve në Kosovë herë i rrëgjonte në të drejta njerëzore dhe kulturore e herë i përparonte në një autonomi shumë më të kufizuar se autonomia e vitit 1974 në kuadrin e Serbisë.

Do të detyrohem të shkruajë kundër kryetarit të Shqipërisë, Sali Berisha, i cili vazhdonte ta furnizonte me naftë Jugosllavinë e mbetur (Serbia dhe Mali i Zi), që ishte vënë në bllokadë ekonomike nga bashkësia ndërkombëtare!

Do të detyrohem të shkruaj kundër politikës së kryetarit të Shqipërisë, i cili ideologjinë e qëndresës vepruese, domethënë ideologjinë e luftës çlirimtare, që do të frymëzojë krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e quante ideologji të terrorizmit, kurse mua personalisht, “ideolog të terrorizmit shqiptar”. Si do të mësoj më vonë, kur do të shkoj në Strasburg e në Uashington, në delegacionet e Kosovës, shumë

prej këtyre shkrimeve publicistike për gjendjen dhe synimet e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, pavarësisht pse kryetari Sali Berisha më kishte shpallur ideolog të terrorizmit, ishin përkthyer në kancelaritë amerikane dhe evropiane.

Në këtë kohë, kur shkrimtari Ismail Kadare vazhdonte në Paris të merrej me letërsi, por edhe të pezmatonte shqiptarët e besimit mysliman me deklarata kundërmyslimane e të predikonte kthimin në fenë e të parëve, në krishterimin, Rexhep Qosja vazhdonte të merrej me shkrime politike e publicistike duke bërë beteja intelektuale për trajtimin evropian të çështjes shqiptare, për pavarësinë e Kosovës, për demokracinë e Shqipërisë e të Kosovës, për fatin evropian të popullit shqiptar në përgjithësi dhe duke pritur çdo natë policët serbë që do ta çonin atje prej nga nuk mund të dinte kur do të kthehej dhe a do të kthehej fare. Ç’kishte atëherë më rëndësi për Kosovën e për Shqipërinë; për demokracinë në Kosovë e në Shqipëri; për evropianitetin e Kosovës e të Shqipërisë - studimi i letrarësisë apo publicistika në fjalë - le ta thotë reaguesi që merret me kronologjinë e punës sime.

KRYEMINISTRI I GJITHKUNDSHËM

Nuk kam pritur, nuk kam pritur sidomos mbasi më kishte shpallur “ideolog të terrorizmit shqiptar” se ish-kryetari i Shqipërisë, Sali Berisha, do të merret rishitazi me mua. Dhe, nuk kam pritur, nuk kam pritur dhe as në ëndërr nuk kam parë, se Sali Berisha do të merret prapë me mua, tani në cilësinë e kryeministrit të Shqipërisë. Por, si e ka thënë shkrimtari i njohur anglez, Gream Grin, në Ballkan janë të mundshme të papriturat më të paimagjinueshme! Në Ballkan është e

mundshme të imagjinohen kentaurë dhe të lindin Drakulla! Në Ballkan dhe vetëm në Ballkan është e mundshme që një ish-kryetar, i cili me politikën e tij ekstremisht të djathtë, e kishte çuar vendin te pragu, madje, pak përtej pragut, të luftës qytetare, i cili me politikën e tij ekstremisht të djathtë i kishte sjellë vendit shumë viktime dhe shumë shkatërrime materiale, i cili me politikën e tij ekstremisht të djathtë, e kishte futur vendin në aventurën financiare të piramidave, i cili gjatë politikës së tij kishte shpallur gjendje të jashtëzakonshme dhe në atë gjendje të jashtëzakonshme ishte rizgjedhur kryetar, i cili, për shkak të asaj politike, me aso pasojash politike, ekonomike, shoqërore dhe morale, ishte përmbysur me revolucion të vonuar demokratik (ashtu siç u përmbysën Shevarnadze në Gruzë dhe Janukoviç në Ukrainë), në Ballkan, pra, dhe vetëm në Ballkan është e mundshme që një ish-kryetar i tillë të rikthehet në politikë dhe të rikthehet, madje, si kryeministër. Dhe, në Ballkan dhe vetëm në Ballkan është e mundshme që një ish-kryetar i tillë të gëzojë përkrahjen, madje, përkrahjen servile, të shkrimtarit që ende festohet si shkrimtar i parë kombëtar, madje, si shkrimtar botëror! Thashë në Ballkan e do të duhej të thuhej: te ne, dhe vetëm te ne! Se vetëm te ne është e mundshme që një ish-kryetar i përmbysur nga pushteti për arsytet për të cilat ishte përmbysur Sali Berisha të rikthehet në pushtet si kryeministër. Thashë në Ballkan e do të duhej të thuhej: te ne, dhe vetëm te ne. Se, vetëm te ne është e mundshme që një shkrimtar, i cili i ka shërbyer diktaturës, pavarësisht si quhet ajo, në mënyrat politike, ideologjike, teorike dhe letrare siç i ka shërbyer Ismail Kadare diktaturës komuniste, të kthehet ngadhënjimtar edhe në demokraci dhe të bëhet mësues i papërgjegjësive intelektuale dhe morale si në kohën e komunizmit.

Nuk iu deshën as nëntë muaj në pushtet, por tani i rikthyer si kryeministër, dhe Sali Berisha filloi të merret edhe me vogëlsinë time. Për fatin tim të mirë, kësaj radhe nuk po më quan më terrorist,

siç më quante kur ishte kryetar, edhe pse terrorizmi është fjala që në fjalorin e tij dhe të shkrimtarit të tij po zëvendëson fjalën komunizëm dhe, ashtu, është bërë fjalë shumë e leverdishme politikisht dhe fjalë shumë e leverdishme letrarisht për ta. Kësaj radhe ish-kryetari i Shqipërisë, tani kryeministër, më ka caktuar fat më të durueshëm: më trajton vetëm të pabarabartë me shkrimtarin e tij!

Pse po merret dhe si po merret me mua ish-kryetari, tani kryeministri ynë?

Për një kryeministër, i cili sillet si shumëministër, i cili në vend të ministrit të Mjedisit flet edhe për punë të ujësjellësve e të kanalizimeve, i cili në vend të ministrit të Ekonomisë flet edhe për punë të tatimeve, i cili në vend të ministrit të Arsimit flet edhe për punë të Akademisë së Shkencave, i cili në vend të ministrit të Bujqësisë flet edhe për punë të gripit të pulave të gjora, i cili në vend të ministrit të Turizmit flet edhe për punë të pastrimit të plazheve, i cili në vend të ministrit të Punëve të Jashtme flet edhe për punë të pasaportave, i cili në vend të ministrit të Shëndetësisë flet edhe për prostitucionin, i cili në vend të ministrit të Rendit Publik flet edhe për xhëpaxhinjtë, i cili gjatë emisionit të lajmeve në TVSH, që fillojnë në orën 20⁰⁰, ngjet të paraqitet shtatë herë, duke marrë kur shtatë e kur shtatëmbëdhjetë minuta, një ish-kryetar, tani kryeministër, në të vërtetë shumëministër i tillë është e kuptueshme, madje, e domosdoshme që ta thotë fjalën, që do të çmohet fjalë e fundit, edhe për një polemikë ashtu të nxehtë siç është polemika midis shkrimtarit të tij, Ismail Kadare, i quajtur shkrimtar (politik) botëror dhe shkrimtarit kundër tij, i quajtur lokal, Rexhep Qosja!

Dhe ta thotë jo gjithkund e para gjithkujt, po atje ku do ta dëgjojë gjithë populli: në konferencë me gazetarët.

Nuk flet ku nuk dëgjohej prej të gjithëve ish-kryetari e tani kryeministri ynë.

Si foli dhe çka foli ai në këtë konferencë me gazetarët?

I pyetur, në këtë konferencë të madhe me gazetarët, në të cilën, përpos gazetarëve të të gjithave mediave, ishin edhe këshilltarë, sekretarë, adjutantë e truproja të tij, denjëtarë vendorë e të huaj, dhe të tjerë të ftuar nergut për ta dëgjuar, i pyetur, pra, se çka mendon për polemikën midis Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qosjes, ish-kryetari, tani kryeministri ynë, Sali Berisha, që në fillim tha:

“Të jem i sinqertë nuk i kam lexuar ato polemika, sepse nuk mund të barazoj të pabarazueshmen, të pabarabartin, jo nuk i barazoj”.

Pikëçuditje!

Ish-kryetari, tani kryeministri ynë, që në fillim e thotë se është i sinqertë - se sinqeriteti është virtyti i tij i dëshmuar gjithmonë e gjithkund. Në sajë të këtij sinqeriteti ai, më në fund, ishte bërë sekretar i organizatës së Partisë së Punës në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë.

Çka thotë mandej ai në këtë sulm të ri të sinqeritetit?

Thotë se nuk i ka lexuar ato polemika!

Pikëçuditje!

E pse nuk i ka lexuar ato polemika për të cilat nuk ngurron të shfaqë mendim ai?

Nuk i ka lexuar sepse ishte i zënë duke lexuar deklaratën servile të Ismail Kadaresë në pamfletin *Pabesia e një polemisti*, në të cilën e arsyeton, siç di ai ta arsyetojë, politikën e tij deri në vitin 1997 dhe e dënon, ashtu siç di ai ta dënojë, revolucionin e vonuar demokratik që e përmbysi atë!

Vetëm për këtë arsye nuk i ka lexuar ato polemika ai?

Jo vetëm për këtë arsye. Nuk i ka lexuar këto polemika edhe për arsye se ai, ish-kryetari, tani kryeministri, nuk mund të barazojë të pabarazueshmen.

Pikëçuditje!

Nuk i ka lexuar ato polemika edhe sepse nuk mund të barazojë të pabarazueshmen?

Jo vetëm pse nuk mund të barazojë të pabarazueshmen, por edhe pse nuk mund të barazojë të pabarabartin.

Pikëçuditje!

Çka bën ish-kryetari, tani kryeministër, kur nuk mund ta barazojë të pabarazueshmen dhe të pabarabartin?

Ia vë vulën e tij kësaj pabarazie në të cilën shkruan: jo nuk i barazoj.

Pikëçuditje!

Va bene.

Edhe pse nuk i ka lexuar ato polemika midis shkrimtarit të tij politik botëror, Ismail Kadare dhe shkrimtarit lokal, Rexhep Qosja, shumëministri ynë do t'i përgjigjet kështu pyetjes: “Ju cilën tezë mbroni për identitetin shqiptar kombëtar?”

“Mendimi kombëtar shqiptar kalon nëpër veprën e Ismail Kadaresë. Dhe në qoftë se Ismail Kadare ka një meritë jo letrare, po më të gjerë, ka meritën se në tërë veprën e tij ka mbledhur copëzat e shpirtit kombëtar. Jo kaq solid. Sepse nuk mund të them se ishte kaq i tranguar, i inkorporuar dhe nga të gjitha kohërat deri më sot e ka mbledhur atë, jo me frymën e një nacionalisti të sëmurë, por e ka mbledhur atë në frymën e një nacionalisti pozitiv qytetar, qytetar tërësisht. Personalisht e kam pasur dhe e kam këtë bindje, që në këtë aspekt Ismaili është rilindësi modern. Të jem i sinqertë, nuk i kam lexuar ato polemika, sepse nuk mund të barazoj të pabarazueshmen, të pabarabartin, jo nuk i barazoj”

Pikëçuditje!

Va bene! Va bene!

Pyetjes mjaftueshmërisht të qartë “Ju cilën tezë mbroni për identitetin shqiptar kombëtar?” i përgjigjet siç shkruan më lart: kodër pas bregut! Meqenëse nuk mund ta lavdërojë për çka kishte thënë për identitetin e shqiptarëve sepse nuk mund të pranojë në njërin anë shpërfilljen e përbërësve myslimanë në identitetin e gjithësishtëm, historik, shqiptar, kurse, në anën tjetër racizmin e tij ndaj popujve myslimanë të Afrikës e të Azisë atëherë ai lavdëron Ismail Kadarenë për diçka tjetër! Është, vërtet, diplomat kryeministri Ynë. Ai e di se për ne dinakëria është mençuria më e madhe! Po të vlerësonte tregimin e Ismail Kadaresë për identitetin e shqiptarëve dhe nevojën e mbajtjes së tyre sa më larg, edhe gjeografikisht, nga Lindja, do të shtrëngohej të

dënonte myslimanofobinë dhe racizmin e tij. Po, meqenëse këtë s'mund ta bënte se do të humbte shkrimtarin e përkushtuar, ai e lavdëron për merita të tjera.

Hajde ta përimitojmë pak këtë deklaratë të kryeministrit tonë dhe të shohim çfarë logjike dhe çfarë etike e stolis atë.

DEDUCTIO AD ABSURDUM (1)

Nga kalon mendimi kombëtar shqiptar? Nëpër cilat rrugë, fusha, male, lumenj, dete, vende, kontinente?

Mendimi kombëtar shqiptar kalon nëpër veprën e Ismail Kadaresë.

Pikë dhe s'ka tjetër! S'ka pikëçuditje!

Dhe në qoftë se Ismail Kadare ka një meritë jo letrare, po më të gjerë, cila është kjo meritë jo letrare po më e gjerë e tij?

Ismail Kadare ka meritën se në tërë veprën e tij ka mbledhur copëzat e shpirtit kombëtar.

Pikëçuditje!

Kush, kur dhe me çka e copëzoi ashtu shpirtin tonë kombëtar?

Nuk ka përgjigje!

Çka doli prej atyre copëzave të shpirtit kombëtar, që mbledhi Ismail Kadare?

Doli një shpirt jo kaq solid.

Pse shpirti kombëtar ishte jo kaq solid?

Sepse nuk mund të them se ishte kaq i tranguar?

Pikëçuditje!

A vetëm sepse nuk mund të thuhet se ishte kaq i tranguar?

Jo, por edhe sepse nuk ishte kaq i inkorporuar.

Pikëçuditje!

Ku do të duhej të kishte qenë kaq i inkorporuar?

S'ka përgjigje!

Kur e pa shpirtin kombëtar ashtu të copëzuar, ashtu të patranguar dhe ashtu të painkorporuar, çka bëri shkrimtari politik Ismail Kadare?

E thashë: mbledhi copëzat e shpirtit kombëtar.

Nga cilat kohëra i mbledhi copëzat e shpirtit kombëtar ai?

Nga të gjitha kohërat deri më sot.

Edhe nga kohërat ilire?

Nuk ka përgjigje!

Edhe nga Mesjeta?

Nuk ka përgjigje!

Edhe nga koha e komunizmit?

Nuk ka përgjigje!

DEDUCTIO AD ABSURDUM (2)

Si i ka mbledhur shkrimtari politik Ismail Kadare copëzat e shpirtit kombëtar, jo kaq solid?

I ka mbledhur jo në frymën e një nacionalisti të sëmurë.

Pikëçuditje!

Po në çfarë fryme i ka mbledhur Ismail Kadare copëzat e shpirtit kombëtar jo kaq solid, ashtu të patrunguar dhe të painkorporuar?

I ka mbledhur në frymën e një nacionalisti pozitiv?

A vetëm në frymën e një nacionalisti pozitiv?

Jo vetëm në frymën e një nacionalisti pozitiv, por edhe në frymën e një nacionalisti pozitiv qytetar.

Pikëçuditje!

Pozitiv qytetar?

Pikëçuditje!

Qytetar tërësisht.

Pikëçuditje!

Çfarë bindje keni pasur për Ismail Kadarenë në këtë aspekt?

Personalisht e kam pasur dhe e kam këtë bindje, që në këtë aspekt Ismail Kadare është rilindës modern.

Kur për njërin thuhet se ishte rilindës modern, mos do të thotë kjo se kemi edhe rilindës tradicional?

Pa dyshim.

Çfarë dallimi ka midis rilindësit modern dhe rilindësit tradicional sipas mendimit tuaj?

Rilindësi modern është nacionalist pozitiv qytetar, qytetar tërësisht, kurse nacionalisti tradicional është nacionalist i sëmurë?

Mos do të thotë kjo se Naim Frashëri, Pashko Vasa, Gjergj Fishta, Ismail Qemali, Andon Zako Çajupi, Faik Konica, Luigj Gurakuqi, meqë ishin nacionalistë tradicionalë, janë nacionalistë të sëmurë?

Nuk ka përgjigje!

Meqenëse Ismail Kadare është nacionalist pozitiv qytetar, tërësisht qytetar, kush është sot nacionalist i sëmurë?

Nacionalist i sëmurë është ai që kuturis të polemizojë me nacionalistin pozitiv qytetar, tërësisht qytetar.

Pikëçuditje! Pikëçuditje! Pikëçuditje!

CONCLUSIO

Çfarë vepre (letrare, shkencore, publicistike) u krijua prej atyre copëzave të shpirtit kombëtar, jo kaq solid, që nuk mund të thuhet se ishte kaq i trungruar dhe kaq i inkorporuar, që mblodhi Ismail Kadare?

U krijua një vepër letrare dhe publicistike moderne.

A mund të thuhet, zoti kryeministër, se prej atij shpirti jo kaq solid, të patrungruar dhe të painkorporuar, përpos asaj vepre letrare dhe publicistike moderne politike, Ismail Kadare krijoi

edhe vepra të realizmit socialist në të cilat njëkohësisht u krijuan një varg mitesh, si miti i komunizmit, miti i proletariatit ndërkombëtar, miti i luftës së klasave, miti i udhëheqësit të madh proletar, i cili prapa kishte historinë, miti i barazisë pa të pabarabartë, miti i ardhmërisë ku do të punosh sa të jesh në gjendje, por do të të jepet sa të kesh nevojë e mite të tjera?

No coment!

Va bene! Va bene! Va bene!

DORA E GJATË E KRYEMINISTRIT

Mbas përimitimit të mësipërm, të cilin ndonjë lexues mund ta lexojë si një skeç humoristik - ndonëse skeç nuk është - është e nevojshme të thuhet edhe disa fjalë për deklaratën që kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka dhënë në konferencë me gazetarët, mbi polemikën midis Ismail Kadarese dhe Rexhep Qosjes, domethënë midis nacionalistit pozitiv qytetar, tërësisht qytetar - si e quan ai të parin dhe nacionalistit të sëmurë - si lë të kuptohet se e quan ai të dytin, midis rilindësit modern - si e quan ai të parin dhe rilindësit tradicional - si lë të kuptohet se e quan të dytin.

Në botën demokratike perëndimore e kur thuhet në botën demokratike perëndimore, zakonisht, mendohet në Evropën Perëndimore dhe në SHBA, në Kanadanë dhe në Australinë nuk mund të ngjasë që një ish-kryetar shteti, një kryeministër, një kryetar Kuvendi, një ministër, të fusin

hundën në polemika midis intelektualëve dhe të japin gjykime e të bëjnë vlerësime në dobi të njërit a të tjetrit pavarësisht nga partishmëria e njërit a tjetrit, pavarësisht nga rëndësia, dobia a mosdobia e çështjeve rreth të cilave polemizojnë ata. Krijimtarisë shpirtërore në botën demokratike i njihet pavarësia të cilën, mendohet, njerëzit politikë nuk duhet ta lëndojnë me gjykimet e tyre politike. Njerëzit politikë në këtë botë mund të jenë miq me krijues të ndryshëm - shkrimtarë, shkencëtarë, filozofë, artistë, por në punë të krijimtarisë dhe të marrëdhënieve të tyre me krijues të tjerë nuk përzihen. Krijimtaria shpirtërore trajtohet e veçantë, prandaj nderohet edhe njëfarë sjellje më pak a më shumë e veçantë e krijuesve. Vetëm në despotitë, në tiranitë, në diktaturat e ndryshme, në rendet totalitare, njerëzit e politikës i kanë lejuar dhe i lejojnë vetes të fusin hundën, duart dhe këmbët në punë të krijimtarisë, në diskutimet midis krijuesve, në polemikat e tyre, në marrëdhëniet e tyre. Nuk mund të thuhet se ish-kryetari e, tani, kryeministri, Sali Berisha, nuk i di rregullat e sjelljes së mirë, normale qytetare, tërësisht qytetare, demokratike të njerëzve të politikës në fushën e krijimtarisë shpirtërore dhe në diskutimet midis krijuesve të ndryshëm. Dhe, nuk mund të thuhet se ish-kryetari dhe, tani, kryeministri Sali Berisha nuk e di sesa shumë dhe sesa përgjithmonë janë komprometuar përzierjet e njerëzve të politikës në fushën e krijimtarisë shpirtërore, përzierjet e despotëve, tiranëve, diktatorëve, kryetarëve, kryeministrave, kryetarëve e sekretarëve të partive, pavarësisht si janë quajtur a si quhen ata, në arte, në filozofi, në shkencë, në jetën, në marrëdhëniet, në diskutimet dhe në polemikat e krijuesve. Sigurisht i di ai të gjitha këto, por kur bëhet kryetar a kryeministër, nuk do t'i dijë. E ka dëshmuar këtë ai edhe në mandatin e parë si kryetar, edhe në mandatin e dytë, mbasi u rizgjodh në gjendje të jashtëzakonshme dhe filloi ta dëshmojë edhe tani, posa u zgjodh kryeministër! Atëherë, gjatë mandatit si kryetar, jo rrallë paraqitej me gjykime për letërsinë, për artet, për shkencat, për krijuesit e ndryshëm letrarë, artistikë, shkencorë. Kujt nuk i kujtohet fjalimi i tij me rastin e

riatdhesimit të trupit të Faik Konicës në Tiranë? Pse të flasim kolegët për të? Ç'rëndësi mund të ketë fjala e tyre? Duhet të flasë kryetari dhe vetëm kryetari i shtetit!

Dhe, jo vetëm kaq dhe jo vetëm kështu. Ai, kryetari, duhej të fliste, madje, ta thoshte fjalën vendimtare për institutet shkencore, për Akademinë e Shkencave, për drejtorët e instituteve dhe për kryetarët e Akademisë.

I zbriste dhe i ngrinte drejtorët e atyre instituteve shkencore! I zbriste dhe i ngrinte kryetarët e Akademisë! E bënte kryetar Akademië dikë që s'ishite anëtar Akademië dhe i kërcënonte se do t'i zhbënte nga anëtarësimi në Akademi anëtarët e Akademisë! I bënte të gjitha këto ish-kryetari dhe, megjithatë, gëzonte simpatinë e deklaruar të Ismail Kadaresë! Si edhe tani!

Dhe, tani, prapë e njëjta këngë! Në duet: kryeministri-shkrimtari!

Kryeministri duhet ta thotë fjalën për gjuhën standarde!

Kryeministri duhet ta thotë fjalën për punët në institutet shkencore dhe për fatin e instituteve shkencore!

Kryeministri duhet ta thotë fjalën për punët në Akademinë e Shkencave dhe për fatin e Akademisë së Shkencave!

Kryeministri duhet ta thotë fjalën për punët në universitetet dhe rreth universiteteve!

Kryeministri duhet ta thotë fjalën, që do të jetë fjala kryesore, fjala-platformë, për polemikën midis dy shkrimtarëve!

Pse jo? Pse jo kur e pyesin gazetarët? Pse jo kur fjala e tij pritet edhe prej shkrimtarit të tij, Ismail Kadare?

Pse jo kur është i gjithëdijshëm i gjithkundshëm dhe i gjithëfuqishëm?

Pse jo kur i lejohet të jetë i gjithëmundshëm, i gjithkundshëm dhe i gjithëfuqishëm?

Pse jo?!

Kryeministri ynë, politikani me gjestet, me sjelljet, me metodën, me stilin, me mentalitetin më joevropian në politikën shqiptare, e ka një shembull prej të cilit ka mësuar shumë, si unë prej Erazmos.

E dini si quhet mësuesi i tij?

Si jo? Kush nuk e di? Quhet Xhugashvilli. Përpos se kryesonte Partinë dhe Shtetin, ai donte të kryesonte mendimet edhe në gjuhësi, në letërsi, në ekonomi, në pedagogji, në psikologji, në filozofi, madje, edhe në astronomi, prandaj nuk ngurronte ta thoshte fjalën e fundit qoftë për Shollohovin e Pasternakun, qoftë për Dostojevskin e Gorkin, qoftë, madje, për psikanalizën dhe teorinë e relativitetit.

Porsi Xhugashvilli për Dostojevskin dhe Gorkin, për Shollohovin dhe Pasternakun, edhe kryeministri ynë do të japë mendimet për Konicën, Ismail Kadarenë dhe vogëlsinë time!

TIPOLOGU I NACIONALIZMIT

Dhe, jo vetëm kaq.

Është e njohur se Xhugashvilli është marrë, “teorikisht”, edhe me çështje të kombit dhe ka bërë një tipologji, ç’është e vërteta të thjeshtë, të nacionalizmit, duke dalluar nacionalizmin pozitiv dhe nacionalizmin negativ. Tipologjinë e mësuesit të tij shpirtëror, kryeministri ynë do ta përpunojë më shkencërisht, prandaj përpos nacionalizmit pozitiv dhe nacionalizmit negativ, do të dallojë edhe nacionalizmin qytetar, tërësisht qytetar, dhe nacionalizmin e sëmurë! Tipologjitë e nacionalizmit prej vitit 1815 e deri sot, që kanë bërë sociologë dhe politikologë bashkëkohorë evropianë dhe amerikanë, atij nuk i hyjnë në punë. Jo. Pse t’i hyjnë në punë atij punimet e atyre që dallojnë nacionalizmin integruar, nacionalizmin humanist, nacionalizmin agresiv, nacionalizmin jakobin, nacionalizmin hegjemonist, nacionalizmin separatist, nacionalizmin përshtirës e tipat e tjerë të nacionalizmit? Me tipat e këtyllë të nacionalizmit nuk mund t’i karakterizojë kryeministri ynë as intelektualët që do të donte të linte pa gojë, as intelektualët që adhuron, që luajnë bishtin sa herë e shohin. Përpos tipave të nacionalizmit pozitiv dhe të nacionalizmit negativ, atij do t’i hynte në punë posaçërisht tipi i nacionalizmit të sëmurë. E për nationalistët e sëmurë, kryeprokurori i Xhugashvillit, Vishinski, kishte paraparë dënim të veçantë: veçimin e pafund në çmëndinën e burgut!

Përpos tipolog i nacionalizmit, kryeministri ynë është edhe kritik letrar dhe historian i letërsisë. Me shije të hollë, vërtet, faikkoniciane, përpos vlerësimit të krijimtarisë së krijuesve të ndryshëm të letërsisë shqipe, ai bën edhe shkallëzimin e tyre varësisht prej rëndësisë gjuhësore-artistike dhe politike të veprës së tyre! Në konferencën e sipërthënë me gazetarët ai do të merret vetëm me

besnikun e tij dhe me mua. Dhe, sigurisht, pas leximit shumëvjeçar të veprave tona, pas shqyrtimeve analitike dhe sintetike të tyre, ka mundur të konstatojë se besniku i tij dhe unë jemi të pabarazueshëm, sepse jemi të pabarabartë!

Në çka e mbështet pohimin e tij kritik, teorik dhe historiko-letrar mbi pabarazinë e Ismail Kadaresë dhe të Rexhep Qosjes? Në gjithë krijimtarinë e njërit e të tjetrit apo në vepra të veçanta të njërit e të tjetrit? Në gjithanshmërinë e njërit dhe në gjithanshmërinë e tjetrit? Në krahasimin, ta themi, midis romanit të njërit, *Dimri i madh* dhe romanit të të dytit, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, që janë botuar përafërsisht në të njëjtën kohë? Në krahasimin e romaneve *Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut* dhe *Një dashuri dhe shtatë faje*, që po ashtu janë botuar përafërsisht në të njëjtën kohë? Në krahasimin e ditarëve të njëkohshëm *Ra ky mort e u pamë* dhe *Tronditja e shekullit?* Në krahasimin e polemikave *Identiteti evropian i shqiptarëve* dhe *Realiteti i shpërfillur?*

Mos konstatimin e tij kritik, teorik dhe historiko-letrar, mbi pabarazinë, në të vërtetë pakrahasueshmërinë e Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qosjes, kryeministri ynë e mbështet në kulturën e përgjithshme të njërit dhe në kulturën e përgjithshme të tjetrit; në njohuritë e njërit dhe në njohuritë e tjetrit për letërsinë botërore; në njohuritë e njërit dhe një njohuritë e tjetrit mbi filozofinë dhe mbi shkencën; në njohuritë teorike dhe metodologjike të njërit dhe në njohuritë teorike dhe metodologjike të tjetrit; në erudicionin e njërit dhe në erudicionin e tjetrit, që dëshmohen në krijimtarinë e tyre letrare, shkencore, publicistike, polemike; në procedimet dhe teknikat e reja krijuese që dëshmohen në veprat e njërit dhe në veprat letrare të tjetrit; në pasurinë e imagjinatës së njërit dhe në pasurinë e imagjinatës së tjetrit; në vëllimin e përgjithshëm të krijimtarisë së njërit dhe në vëllimin e përgjithshëm të krijimtarisë së tjetrit; në kontributin e përgjithshëm krijues dhe intelektual të njërit dhe në kontributin e përgjithshëm krijues dhe

intelektual të tjetrit për kulturën kombëtare; në kontributin intelektual dhe politik të njërit dhe në kontributin intelektual dhe politik të tjetrit për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe të çështjes shqiptare në përgjithësi; në kontributin e njërit dhe në kontributin e tjetrit për demokracinë në jetën kombëtare? Në pyetjet e këtilla kryeministri ynë, që bëhet njëkohësisht kritik letrar dhe historian i letërsisë, nuk na jep përgjigje. Pse ta japë? Dhe, si ta japë?

Konstatimin e tij kritik, teorik dhe historiko-letrar mbi pabarazinë, në të vërtetë mbi pakrahasueshmërinë e Ismail Kadaresë dhe të Rexhep Qosjes, kryeministri ynë e mbështet jo në krahasimin e të dhënave të sipërthëna, që mund të shihen në krijimtarinë e njërit e në krijimtarinë e tjetrit; konstatimin e tij kritik, teorik dhe historiko-letrar mbi pabarazinë, në të vërtetë mbi pakrahasueshmërinë e Ismail Kadaresë e të Rexhep Qosjes ish-kryetari dhe, tani, kryeministri ynë duket se e mbështet në shërbimet e të parit dhe në kritikën e të dytit?

Le ta mbështesë!

Se ish-kryetari e, tani, kryeministri ynë, Sali Berisha, ka qejf që në njërin anë të ketë të pakrahasueshëm, domethënë të pabarabartë, kurse, në anën tjetër, të shquajë të parë, domethënë bajraktarë, u binda këto ditë mbas raportit të UNICEF-it, në të cilin, përpos të tjerash, thuhej se në Shqipëri ka rreth 190 mijë fëmijë të braktisur, që jetojnë në varfëri të skajshme. Kryeministri i Shqipërisë ka kohë që të merret me polemika midis intelektualëve dhe me intelektualë, por kryeministri i Shqipërisë nuk ka kohë që të merret me fëmijët e braktisur, me kushtet, në të cilat i zë nata dhe i çel mëngjesi ata fëmijë të gjorë. I zuri në gojë, por pa bërë siç e ka zakon ai, vetëm mbasi u shpall raporti i UNICEF-it. Dhe, çka tha se? Tha se prej tash, e kjo prej tash do të

thotë prej çastit kur e çeli ai gojën për ta, fëmija do të jetë në Shqipëri, derisa ai të jetë kryeministër, “i pari i të parëve”!

Fëmija, pra, do të jetë “i pari i të parëve”!

Fëmijët do të jenë të parët e të parëve!

Si Ismail Kadare në letërsi! Në letërsinë e politizuar!

Si Sali Berisha në politikë!

Mbasi e dëgjova raportin e UNICEF-it për numrin e fëmijëve të braktisur nën pushtetin e Sali Berishës e kuptova pse kryeministri i Shqipërisë u fut në polemikën midis Rexhep Qosjes dhe Ismail Kadaresë, por pa u distancuar nga racizmi i Ismail Kadaresë ndaj arabëve, ndaj myslimanëve në ish-republikat e Bashkimit Sovjetik, ndaj të ngjyrosurve në përgjithësi, pale dhe ndaj kujt tjetër!

Shumëçka s’duhet të kuptoj se shumë shtrenjtë po më kushtojnë këto që po i kuptoj!

EDHE KRYEPARLAMENTARJA FUTET NË POLEMIKË

Edhe kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, e quajti të nevojshme që të inkuadrohet në polemikën midis Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qosjes. Për dallim prej kryeministrit, Sali Berisha, i cili hyrjen e tij në polemikë e bëri botore në konferencën me gazetarët në Tiranë,

kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli, e bëri këtë në Konferencën Evropiane të Kryetarëve të Kuvendeve, në veri të Evropës. Me atë rast, para kryetarëve të kuvendeve të vendeve evropiane, ajo e quajti të arsyeshme, madje, të domosdoshme, të përmendë historinë shqiptare që, si tha, “daton përpara 2000 vjetësh”; të përmendë gjeografinë shqiptare që, si tha, “na ka vendosur jo në cep, por në brendësi të Evropës”; dhe të përmendë, në fund, edhe identitetin e shqiptarëve të cilin, e quajti të domosdoshme ta quajë, “tërësisht evropian”, pra, jo pjesërisht, po “tërësisht evropian”!

Sikundër mund të shihet, edhe për kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, si edhe për Ismail Kadarenë, gjeografia është përcaktuesja vendimtare e identitetit të vetjeve dhe të popujve. Për këtë shkak, ndoshta, ajo u mbajti kryetarëve të Kuvendeve të Vendeve Evropiane një mësim nga gjeografia (dhe antropologjia) me ç’rast bëri përpjekje që, sikundër Ismail Kadare, ta fusë Shqipërinë sa më në brendësi të Evropës, duke e larguar sa më shumë prej Turqisë dhe, në përgjithësi, prej Lindjes turko-arabe me shpresë se ashtu do ta largojë prej atyre përbërësve të kulturës e të qytetërimit të asaj Lindje që mund t’iu kenë ngjitur dikur a mund t’i ngjiten tani Shqipërisë! Edhe zonja Jozefina Topalli gjatë përpjekjes së saj për ta rehatuar Shqipërinë sa më larg Lindjes myslimane, e harroi Kosovën dhe e la aty ku e kishte lënë Ismail Kadare kur tha se sa i përket identitetit, “Letrat e Shqipërisë janë të qarta”!

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, harroi se popujt e brendësisë së Evropës, prej më të vegjëlve e deri te më të mëdhenjtë, jo vetëm Shqipërinë po krejt Ballkanin e vendosin mu në cepin e Evropës. Për këtë arsye edhe kanë krijuar nocionet gjeografike Ballkani Perëndimor e Ballkani Juglindor. Ata, sigurisht, nuk mërzhiten si kryeparlamentarja jonë, Jozefina Topalli, dhe si shkrintari ynë, Ismail Kadare, pse Shqipëria dhe Ballkani në tërësi gjenden në cep

të Evropës. Dhe, pse të mërzhiten? Në cep të Evropës, të Veriut të Evropës, janë Finlanda, Norvegjia dhe Suedia, kurse në cep të Jugut të Evropës janë Portugalia, Spanja dhe Italia. Pavarësisht pse në anën tjetër të Mesdheut i kanë vendet e Veriut afrikan, as Portugalia, as Spanja, as Italia nuk kanë dëshmuar ndonjëherë se mërzhiten pse i Madhi Zot i ka vendosur në cepin jugor të Evropës. Në qoftë se marrin parasysh se vendosja gjeografike në cepin jugor të Evropës u sjell dobi të mëdha prej turizmit, atëherë mund të besojmë se cepin nuk do të pranonin kurrsesi ta ndërrojnë me brendësinë e Evropës.

Mund të besohet se përpjekja e kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, për t'i bindur njëherë e përgjithmonë kolegët e vet, kryeparlamentarët e vendeve evropiane, se Shqipëria nuk gjendet në cep, po në brendësi të Evropës dhe se identiteti i shqiptarëve është jo vetëm evropian, po “tërësisht evropian”, do t'i ketë shtyrë ata t'i bëjnë njëri-tjetrit dy pyetje: e para, pse ka nevojë kjo zonjë ta lëvizë Shqipërinë prej cepit të Evropës, ku e ka vendosur i Madhi Zot dhe ta çojë në brendësi të saj dhe, e dyta, pse ka nevojë kjo zonjë ta theksojë, madje, ta tejtheksojë se shqiptarët kanë identitet evropian, madje, “tërësisht evropian”? Do ta kenë pyetur ashtu njëri-tjetrin, në radhë të parë, për arsye se shumica prej tyre do të kenë qenë për vizita zyrtare edhe në Shqipëri, edhe në Maqedoni, edhe në Kosovë dhe gjatë këtyre vizitave mund të kenë parë shumëçka në gjeografinë shqiptare dhe mund të kenë mësuar për historinë shqiptare, që është evropiane dhe jashtevropiane, dhe nuk janë mrekulluar nga evropiania e saj dhe nuk janë shastisur nga jashtëevropiania e saj - si ajo. Kështu, për shembull, mund të kenë mësuar se historia shqiptare rreth 500 vjet ishte e lidhur me historinë e Perandorisë Otomane dhe gjatë këtyre pesë shekujve përqindja më e madhe e shqiptarëve kishin marrë fenë myslimane dhe, mandej, shumëçka prej kulturës dhe qytetërimit mysliman. Të kujdesshëm në sjellje qysh dinë të jenë

evropianët e, sidomos, politikanët, ata nuk do t'i kenë thënë zonjës sonë: gjithë ato xhamia në gjeografinë shqiptare, gjithë ata hoxhallarë e myezinë, gjithë ato medrese, gjithë ata haxhi që shkojnë në Qabe, gjithë ata të vjetër e të rinj, fshatarë e intelektualë që mbushin xhamitë dhe hapësirat para xhamive të xhumave, gjithë ato varrime dhe gjithë ato varre në të cilat varrimet bëhen me ritualin mysliman, gjithë ata të bërë synet - rreth pesë milionë shqiptarë të bërë synet, e shumëçka tjetër, flasin për një identitet evropian të shqiptarëve vetëm me kushtin në qoftë se identitetin evropian nuk e njëjtësojmë me krishterimin. Se, gjithë ato që u përmendin janë përbërës të kulturës dhe të qytetërimit mysliman në identitetin e shqiptarëve, që bashkë me përbërësit e kulturës dhe të qytetërimit të krishterë ndërtojnë IDENTITETIN E GJITHËSISHËM HISTORIK SHQIPTAR.

Sidoqoftë, retorika e kryetares së Kuvendit të Shqipërisë mbi zhvendosjen e Shqipërisë (pa Kosovën, pa Maqedoninë, pa Luginën e Preshevës dhe pa Malin e Zi) prej cepit të Evropës në brendësi të Evropës dhe njëjtësimi i identitetit të shqiptarëve tërësisht me fenë e krishterë nuk flet mirë për politikën tonë. Kjo retorikë dëshmon se politika jonë vazhdon të jetë shumë e shtirë dhe shumë servile. Dhe, e bërë me gjuhë të tillë të shtirë, servile e të rrejshme, kur e kur bëhet edhe dëmsjellëse. Evropa dhe SHBA s'duan të pavërteta, s'duan gënjeshtër.

SHNDËRRIMET E LEVERDISHME

Si vlerësimi i kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha, për pakrahasueshmërinë midis Ismail Kadarese dhe Rexhep Qosjes, ashtu edhe deklarata e kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, për

identitetin shqiptar, e nxitur prej polemikës midis tyre, tregojnë se sa të thella janë rrënjët e mentalitetit komunist në politikën tonë. Pavarësisht pse quhen njerëz politikë në rend demokratik, ata nuk ngurrojnë ta vazhdojnë praktikën komuniste të mbajtjes nën shtetull të krijuesit që u shërben dhe të përndjekjes së krijuesit që kritikon!

Ç'është e vërteta, Ismail Kadare është kujdesur që lajkatueshëm t'i ftojë ta marrin nën shtetull. Duke ditur se ku i dhemb dhe me çka mund ta mallëngjëjë kryeministrin Sali Berisha ai do ta shfrytëzojë pamfletin *Pabesia e një polemisti* për ta paraqitur atë si ngadhënjyes politik e moral në ngjarjet e vitit 1997, që rëndojnë shumë tragjikisht në jetëshkrimin politik të ish-kryetarit dhe, tani, kryeministrit të Shqipërisë. Edhe pse në përgjigjen ndaj sprovës së tij me të cilën e kishte filluar këtë polemikë nuk e kisha përmendur vitin 1997, Ismail Kadare nuk do të ngurrojë që atë vit ta përdorë për ta ngritur disponimin e padronit të tij të ri kundër meje! Dhe, do të shkruajë: “Në atë kohë (në vitin 1997 R. Q.), shqiptarët, kudo që gjendeshin, ranë në zi e në depresion. E midis zizë u ngrit veç një zë i ngazëllyer që e përshëndeste atë gjëmë, duke e pagëzuar si “revolucion i vonuar demokratik”. Përfundimet që nxjerr Ismail Kadare prej kësaj fjalie janë këto: shqiptarët, kudo gjendeshin ata, në pranverë të vitit 1997, ranë në zi e në depresion sepse prej pushtetit ra Sali Berisha. Oh, sa gjëmë e madhe! E dëgjoji atë gjëmë për Sali Berishën edhe Ismail Kadare në Paris! E dëgjoji dhe u përlot! Por, e vërteta për vitin 1997 kurrsesi nuk është ajo që e thotë Ismail Kadare. Sikur shqiptarët të kishin rënë në zi e në depresion nuk do të kishte pasur kush t'i tregonte Sali Berishës se Shqipëria e vitit 1997 nuk mund të sundohet me venomet e vitit 1917. Me politikën e tij ekstremisht të djathtë ai shkaktoi deformime të mëdha, të padurueshme në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit, prandaj populli u ngrit kundër asaj politike. Në të vërtetë populli shqiptar në Shqipëri, në vitin 1997, bëri revolucion demokratik të vonuar, të vonuar për shkak se rendi i vendosur në vitin 1991, pas rënies së komunizmit, u kthye

shpejt në despotizmin e, si e quajti gazeta angleze *The economist*, njeriut të shekullit tetëmbëdhjetë që kishte në duar mjetet teknike të shekullit njëzet! Ismail Kadare e di se me revolucione të quajtura të mëndafshta, të portokallta, demokratike, u përmbysën edhe Millosheviqi në Serbi, edhe Shevernadze në Gruzë, edhe Janukoviçi në Ukrainë, i cili, si Sali Berisha në Shqipëri, u rikthye sivjet në pushtet. Historia nuk shkon vetëm përpara, por, fatkeqësisht, ndonjëherë kthehet edhe mbrapa. Ardhja e Sali Berishës në pushtet në Shqipëri, si edhe ardhja e Janukoviçit në Ukrainë, është një kthim i këtyre mbrapa i historisë së Shqipërisë si i historisë së Ukrainës.

Nuk mund të thuhet se Ismail Kadare nuk di gjë për revolucionet e mëndafshta, revolucionet demokratike dhe ecjet e historisë jo vetëm përpara, por ndonjëherë edhe mbrapa.

Por, si për shumëçka tjetër, ashtu edhe për vitin 1997, për revolucionin e vonuar demokratik dhe për kryeministrin e tanishëm të Shqipërisë, prej Ismail Kadaresë nuk mund të pritet e vërteta: prej tij mund të pritet vetëm “e vërteta” që për të është e leverdishme! Të lëmë, prandaj, mënjane, zinë dhe depresionin e Ismail Kadaresë pse në vitin 1997 populli përmbysi regjimin despotik oriental të Sali Berishës dhe ta lëmë mënjane pa brejtje të ndërjegjes pse po lëmë mënjane vajin e një shkrimtari me shumë popullorësi, i cili shqiptarët që kundërshtojnë regjimin as më parë e as më vonë s’ka ngurruar t’i quajë kur halldupë, kur jashtëqitja e kombit! Të lëmë mënjane vajtimin e tij për fatin e Sali Berishës në vitin 1997 dhe gëzimin e tij për rikthimin e tij në pushtet në vitin 2005 dhe të shohim se me çfarë shkathhtësie është kujdesur dhe vazhdon të kujdeset ai që t’i ndërrojë qyrqet politike në varësi nga stinët politike.

Nuk është aspak e mundimshme të konstatohet se, duke filluar prej përmbledhjes së parë, *Frymëzime djalosbare*, e cila paralajmëronte një talent të ri në letërsinë shqipe, që do ta përjetësonte idenë

komuniste, e deri te sprova *Identiteti evropian i shqiptarëve* dhe vetintervista *Pabesia e një polemisti*, Ismail Kadare nxiton që të paraqesë dëshmi të shkruara - në vargje, në prozë, në publicistikë e në eseistikë se mendon dhe krijon në frymën e kohës e kjo në frymën e kohës për të do të thoshte në pajtim me kërkesat e Partisë së Punës - dikur, kurse në pajtim me kërkesat e tregut politik - sot. Një pjesë e madhe, shumë e madhe e krijimtarisë së tij jo vetëm publicistike, por edhe në poezi e në prozë, mban vulën e këtij nxitimi për t'iu përshtatur këtij tregu e kjo do të thotë për të përfutur për veten, për statusin vetjak në çdo situatë.

Shembujt janë të shumtë.

Ja disa prej tyre, sado po të mënjanojë shembujt e moshës së re.

Kur e ka quajtur të leverdishme ta arsyetonte prishjen e Shqipërisë komuniste me Bashkimin Sovjetik “revizionist”, e cila, në vend se të sillte lidhjen me Perëndimin - me Evropën Perëndimore dhe SHBA apo zbutjen e dogmatizmit ideologjik e politik shqiptar, do të sjellë ashpërsim të madh dhe kthim nga Kina për së tepërmi e dogmatizuar, Ismail Kadare do të shkruajë *Dimrin e madh*, në të cilin Enver Hoxha do të përjetojë apoteozën më të madhe, historike, do të ngrihet në figurë mitologjike kombëtare, dhe do ta përjetojë këtë apoteozë mitologjizuese për çka se?: pse e kishte shpëtuar Shqipërinë nga revizionizmi hrushçovian, kurse Bashkimi Sovjetik do të përjetojë kritikën më shkatërruese pse po e tradhtonte marksizëm-leninizmin burimor, domethënë stalinian, që ishte flamuri i atëhershëm i Ismail Kadaresë!

Kur e ka quajtur të leverdishme ta arsyetojë “teorikisht” rolin historik të Shqipërisë në luftën për mbrojtjen e pastërtisë ideologjike të marksizëm-leninizmit, në të vërtetë të stalinizmit, në njërin anë nga rreziku prej imperializmit amerikan e, në anën tjetër, nga rreziku prej revizionizmit sovjetik, Ismail

Kadare do të shkruajë artikuj për nevojën e ruajtjes së karakterit kombëtar dhe marksist-leninist të krijimtarisë shpirtërore: të letërsisë, të arteve në përgjithësi dhe të shkencës, ndër të cilët hyn edhe artikulli *Rreth ndikimeve të huaja dhe karakterit kombëtar të letërsisë*, të botuar në gazetën *Zëri i popullit* më 8. 4. 1973.

Kur e ka quajtur të leverdishme të propagandojë artistikisht sloganin e Partisë së Punës dhe, natyrisht, të sekretarit të saj, Enver Hoxha, se Shqipëria komunistë është një kështjellë e pamposhtshme, së cilës nuk kanë çka t'i bëjnë as imperialistët amerikanë, as revizionistët sovjetikë, se Shqipëria komuniste, në të vërtetë, është një kështjellë në të cilën vetëm sa mund të thyejnë dhëmbët edhe të parët, edhe të dytët, edhe Hrushçovi, edhe Kenedi i lavdishëm, Ismail Kadare do të shkruajë romanin me temë nga koha e luftërave kombëtare kundërturke në krye me Gjergj Kastriotin - Skënderbeun. Dhe, ky roman, i shkruar me frymëzime politike dhe ideologjike, në sajë të temës së “largët” historike, dhe, natyrisht, prirjes rrëfimtare të autorit, pavarësisht prej pikënisjes propagandistikë, do të dalë roman i suksesshëm, për dallim prej *Dimrit të madh*, i cili do të mbetet një roman politik i dobët, në të vërtetë një publicistikë e shkruar në trajtë të prozës letrare.

Kur e ka quajtur të leverdishme t'u bëjë jehonë direktivave Partiake mbi shndërrimet revolucionare në jetën e fshatit shqiptar, Ismail Kadare do të shkruajë romanin - reportazh, *Dasma*, në të vërtetë romanin - jehonë e revolucionit kulturor kinez në Shqipëri!

Kur e ka quajtur të leverdishme t'u bëjë jehonë ngjarjeve, figurave historike, ideologjike dhe politike kombëtare, kongreseve, datave partiake e shtetërore, Ismail Kadare do të shkruajë vjersha, poema, artikuj, sprovë, trajtesa me të cilat do t'i popullarizojë ato ashtu siç dëshirohej nga udhëheqja politike e

shtetërore që të popullarizoheshin dhe do të satirizojë “pashallarët e kuq”, që vijën politike të Partisë, ideologjinë e saj, po e deformonin, duke e shfrytëzuar për leverdi vetjake!

Posa ka rënë komunizmi dhe e ka quajtur të leverdishme sa më parë të distancohet nga idhulli i tij, babai i tij shpirtëror, frymëzuesi i tij, Enver Hoxha, Ismail Kadare do të fillojë një fushatë të jashtëzakonshme, të pandërprerë, kundër tij.

E kaluara vetjake, bamirësia e diktatorit ndaj tij, nuk e kishin penguar as një grimë pabesinë e tij dhe nuk e kishin penguar jo ku s’do të duhej ta pengonin - në kritikën e regjimit të tij, po ku do të duhej ta pengonin - në trillimin e gënjeshtreve për jetën intime dhe qëllimet e tij - siç është, fjala vjen, pohimi se me uri donte ta lodhte popullin për ta sunduar më lehtë!

Kur do ta quajë të leverdishme që Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ta quajë çlirimtare, Ismail Kadare ashtu do ta quajë, por kur partitë e krijuara nga radhët e UÇK-së dhe përkrahësit e saj i kanë humbur zgjedhjet në vitin 2000, Ismail Kadare menjëherë do ta ndërrojë pllakën, duke harruar çka kishte shkruar dje për UÇK-në dhe do të fillojë t’u këndoje këngë atyre që ishin ngritur kundër saj dhe luftës së saj, madje edhe atyre që gjatë luftës kishin kërkuar ndërprerjen e fushatës së bombardimeve mbi Serbinë, mbi ushtrinë e policinë e saj, madje, do t’u këndoje këngë edhe atyre që gjatë luftës do t’i çojnë dhurata Millosheviqit në shtëpinë e tij në Beograd dhe do të provojnë të formojnë qeveri kuislinge në Prishtinë!

Kur do ta quajë të leverdishme ta quajë aventurë komuniste krijimin e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, Ismail Kadare do t’i quajë pjesëtarët e saj “këlyshë të Enverit”, por kur faktorët ndërkombëtarë do ta shpallin të ligjshme këtë ushtri dhe do t’i pranojnë përfaqësuesit e saj si palë të ligjshme në bisedimet për statusin e shqiptarëve në Maqedoni, Ismail Kadare do t’i rehabilitojë

“këlyshët e Enverit” dhe shumë shpejt do të gjejë mangetofonat që do ta ndërrojnë edhe disponimin e tyre ndaj tij!

Kur do të bëhen protestat e rinisë shkollore më 17 e 18 mars 2004 në Kosovë, në të cilat do të bëhen edhe veprime të papranueshme e të palejueshme, siç ishte dëmtimi i disa monumenteve serbe të kultit e i disa shtëpive të romëve e egjiptianëve, Ismail Kadare do të nxitojë që t’i “zbulojë” organizuesit e tyre në radhët e komunistëve dhe islamistëve kosovarë, duke quajtur kështu edhe komunistë edhe islamistë fëmijët, shumica prej të cilëve ishin në djepa në kohën e komunizmit!

Dhe, kështu prej viti në vit, kur e kur edhe prej muaji në muaj!

Dhe, kështu, duke u shndërruar sipas leverdive politike dhe letrare, Ismail Kadare do të mbërrijë deri te prova e ngjyrosur me racizëm *Identiteti evropian i shqiptarëve*, në të cilën do të përmbledhë disponimin e tij kundër Lindjes, sidomos turko-arabe, kundër përbërësve myslimanë në identitetin e gjithësishtëm, historik të shqiptarëve; dhe deri te ftesat për kthim në fenë e të parëve të bërë gjithnjë me qëllim që t’u shërbejnë leverdive të tij që përmblihen në një qëllim: në çmimet letrare! A vetëm në çmimet letrare?

Dhe, kështu, prirja për shndërrime ashtu të shpeshta do të bëhet pika e alefit (e Horhe Luis Borhesit) në të cilën do të takohen sukseset politike e letrare të Ismail Kadaresë, në të cilën, në të vërtetë, do të takohen popullorësia e tij e mbështetur politikisht, shërbimet që bën ai për këtë popullorësi dhe rënia e tij intelektuale-morale.

Dhe, kështu, dëshira për të ikur sa më larg prej të kaluarës komuniste dhe prej të tanishmes myslimane e qet Ismail Kadarenë në pozita mendore kur e kur ekstreme, duke i bërë shndërrimet e tij tepër

theqafëse dhe duke shkaktuar tollovi logjike e morale në shkrimet e tij publicistike, prandaj edhe në polemikën mbi identitetin e shqiptarëve.

PËRFUNDIM

Po i kthehem edhe njëherë kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha.

Pjesëmarrjen e tij, të shkurtër, po të efektshme, në polemikën midis Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qosjes, kryeministri ynë, Sali Berisha, e përfundoi tamam ashtu siç i përfundojnë, zakonisht, politikanët krahinorë pjesëmarrjet në ngjarje kulturore: duke dekoruar kushërinjtë dhe besnikët e tyre. Ai e dekoroi me këtë rast oponentin tim me një medalje të çmuar, në të cilën me shkronja të arta kishte shkruar: ISMAIL KADARE – RILINDËS MODERN!

Kryeministri ynë, sigurisht, ka dëgjuar për rilindësit, por medalja me të cilën e stolisi gjoksin e shkrimtarit, të përkushtuar ndaj tij me një ndërprerje të shkurtër kur socialistët ishin në pushtet, tregon se ai rilindësit ose nuk i ka lexuar, ose nuk i ka kuptuar.

Pse mund të thuhet kështu?

Mund të thuhet kështu sepse, po t'i kishte lexuar dhe po t'i kishte kuptuar si do të duhej të kuptoheshin veprat e tyre dhe porositë që u kanë lënë brezave të ardhshëm, kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, nuk do ta dekoronte ashtu lehtë Ismail Kadarenë me medaljen në të cilën është shkruar togfjalëshi “rilindës modern”.

Dhe, nuk do ta dekoronte për tri arsye kryesore:

e para, nuk do ta dekoronte për arsye se rilindësit tanë, kurrë dhe kurrkund, nuk kanë shprehur ide raciste ndaj Lindjes turko-arabe, në përgjithësi myslimane, siç shpreh Ismail Kadare në sprovën “Identiteti evropian i shqiptarëve”;

e dyta, nuk do ta dekoronte për arsye se rilindësit tanë kurrë dhe kurrkund, pavarësisht a ishin myslimanë, katolikë a ortodoksë, nuk i kanë lejuar vetes të shprehin qëndrime kundërmyslimane, siç shpreh Ismail Kadare tani e pesëmbëdhjetë vjet të shkuara, duke filluar prej veprës publicistike “Nga një dhjetor në tjetrin”;

e treta, nuk do ta dekoronte për arsye se rilindësit tanë, kurrë dhe kurrkund, pavarësisht a ishin katolikë, ortodoksë a myslimanë, nuk i kanë lejuar vetes të bëjnë propagandë në dobi të fesë së krishterë, katolike a ortodokse, dhe nuk i kanë ftuar bashkëkombësit të kthehen në fenë e të parëve, domethënë në fenë e krishterë, siç po bën Ismail Kadare tani e pesëmbëdhjetë vjet të shkuara, duke filluar prej veprës publicistike “Nga një dhjetor në tjetrin” dhe siç bëri edhe në sprovën “Identiteti evropian i shqiptarëve”.

Intelektualë të pakorruptueshëm, vetje me karakter të fuqishëm, të cilët as nuk shiteshin, as nuk mund të bliheshin me asnjë çmim, atdhetarë të përkushtuar deri në vdekje ndaj Atdheut të vet - Shqipërisë, ata kurrë nuk do të shfaqnin mendime dhe kurrë nuk do të bënin veprime, me të cilat do të mohohesh pluralizmi fetar, do të cenohej baraspesha fetare e me të cilat do të ndikonin shpërbërshëm (çintegrueshëm) në shoqërinë shqiptare.

E kuptueshme.

Ata ishin të vetëdijshëm se për Shqipërinë dhe për bashkimin e popullit shqiptar mund të punohej vetëm duke mbrojtur idenë e pluralizmit fetar dhe duke nderuar njësoj që të tri fetet të cilave u takonin bashkëkombësit e tyre: fenë katolike, fenë ortodokse dhe fenë myslimane, domethënë duke i trajtuar plotësisht të barabarta dinjitetet e të tri këtyre feve. Të vetëdijshëm për këtë, ata e kishin bërë ideal jetësor, që do të ketë rol aq të madh për tolerancën fetare dhe për bashkimin e popullit shqiptar, sloganin historik: FE E SHQIPTARËVE ËSHTË SHQIPTARIA.

Nuk është e çuditshme, prandaj, pse Qeveria e themeluesit të shtetit shqiptar, Shqipërisë, e pjesëtarit të brezit të fundit të rilindësve, qeveria e Ismail Qemalit të lavdishëm, e konsideronte vepër penale shfrytëzimin e fesë për nevoja politike. Apo politiko-letrare!

Të shprehësh qëndrime kundër njëres prej këtyre tri feve, siç po bën kohë pas kohe Ismail Kadare kundër fesë myslimane dhe të bësh propagandë në dobi të njëres a në dobi të dy prej këtyre feve, siç po bën Ismail Kadare në dobi të krishterimit, do të thotë të ngrihesh kundër idealit të rilindësve. E ata që në jetën shqiptare, në kulturën dhe në politikën shqiptare, ngrihen kundër idealit të rilindësve – pluralizmit fetar dhe - trajtimit të barabartë të dinjiteteve të të tri feve të shqiptarëve, nuk mund të jenë as rilindës modernë, as kurrfarë rilindësish.

Propaganda fetare me të cilën po merret Ismail Kadare tani e pesëmbëdhjetë vjet të shkuara, qoftë ajo në dëm të fesë myslimane, qoftë ajo në dobi të fesë së krishterë, pikërisht pse është propagandë në kundërshtim me idealin e rilindësve, në thelbin e vet është veprimtari që mund të ketë vetëm efekte kundër kombëtare.

Në çdo vend në këtë botë, ku jetojnë pjesëtarë të feve të ndryshme, pavarësisht janë apo nuk janë të një prejardhjeje etnike, dinjitetet e feve trajtohen plotësisht, dhe vetëm plotësisht, të barabarta.

Nuk ka fe më shumë dhe fe më pak të mirë; nuk ka fe më shumë dhe fe më pak të dinjitetshme; nuk ka fe që më shumë se fetë e tjera meriton të predikohet dhe fe që duhet të diskriminohet. Ndjenjat fetare janë ndjenja të veçanta. Në politikat e mençura, që i bëjnë njerëz largpamës, nuk harrohet se feja nuk pranohet kollaj, por as se feja nuk ndryshohet kollaj. Të mohosh pluralizmin fetar, të shprehësh qëndrime kundër një feje, në këtë mes kundër fesë myslimane, siç bën Ismail Kadare tani e pesëmbëdhjetë vjet të shkuara dhe siç bëri edhe në sprovën që ka nxitur këtë polemikë; të përkrahësh me shkrim ato qëndrime siç bënë disa përkrahës të tij; dhe, më në fund, të sillesh ndaj atyre qëndrimeve siç u sollën kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha dhe kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, do të thotë të tregohesh i papërgjegjshëm ndaj çështjeve që kërkojnë përgjegjshmëri të madhe dhe të vazhdueshme.

Këto tregojnë se sa shumë është e nevojshme që në Shqipëri dhe në Kosovë të bëhet çka është bërë me kohë në shumë vende jo vetëm me popullsi shumëfetare, por edhe njëfetare: të miratohet ligji për fenë. E në ligjin për fenë, ndoshta, do të shpallehin të komprometueshme jo vetëm idetë raciste dhe qëndrimet kundër kësaj a asaj feje, po edhe përkrahja që ideve dhe qëndrimeve të tilla ngjet t'u jepet me heshtje ose ndërmjetueshëm prej institucioneve politike, partiake a shtetërore.

Duke i dhënë fund kësaj përgjigjeje lexova se Ismail Kadare e ka ngritur edhe një shkallë më lart fyerjen ndaj meje! Nuk do t'i përgjigjem me thënien e popullit: i merituari për përbuzje - përbuz! Nuk do t'i përgjigjem as me thënien e shkrimtarit të njohur amerikan, Logan Smith: “Ai që përbuz tjetrin, ai zakonisht ka arsye të frikësohet vetë nga përbuzja”.

Por, do t'i përgjigjem me: asgjë e çuditshme! Pse të mos më fyejë edhe mua Ismail Kadare, kur ai qe pesëmbëdhjetë vjet fyen rreth pesë milionë shqiptarë myslimanë në Ballkan? Pse të mos më fyejë edhe mua Ismail Kadare kur qe pesëmbëdhjetë vjet ai fyen të gjithë shqiptarët myslimanë në diasporë? Pse të mos më fyejë edhe mua Ismail Kadare kur qe pesëmbëdhjetë vjet fyen elitën e vdekur kulturore dhe politike kombëtare: Abdyl Frashërin, Naim Frashërin, Sami Frashërin, Hoxha Tahsinin, Ismail Qemalin, Lumo Skendon, Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Eqrem Çabejn e shumë të tjerë! Si me idetë raciste dhe qëndrimet kundërmyslimane të shprehura në sprovën që ka nxitur këtë polemikë, ashtu edhe me gjuhën agresive, fyese, përbuzëse që po përdor, ai vetëm sa po përpiqet të arsyetojë programin e tij “profetizues” fetar të shprehur në veprën publicistike “Nga një dhjetor në tjetrin”, në vitin 1991, në të cilin, përpos të tjerash, thuhet: “përria e Shqipërisë do të ishte drejt fesë së krishterë, ngaqë ajo lidhej me kulturën, kujtimet e vjetra dhe nostalgjinë e kohës paraturke. Me kalimin e viteve feja e vonë islamike, e ardhur bashkë me otomanët, do të zbehej, (së pari në Shqipëri e më pas në Kosovë), gjersa t'ia linte vendin fesë së krishterë, ose më saktë kulturës së krishterë. Kështu që së paku nga një e keq (ndalimi i fesë më 1967), do të vinte një e mirë. Kombi shqiptar do të bënte një korrigjim të madh historik, çka do të shpejtonte bashkimin e tij me kontinentin mëmë: Evropën.” Ç'mund t'i thuhet tani pas botimit të librushkës raciste “Identiteti evropian i shqiptarëve”, këtij projektuesi të konvertimit kolektiv të pesë milionë shqiptarëve në Ballkan - projektuesit të një tragjikomodie shqiptare? Për t'iu përgjigjur si duhet, në të vërtetë për t'i shpjeguar motivet e majmunërive të këtilla mendore të Ismail Kadesë do të duhej të bëhej përimtimi sociologjik dhe psikologjik i kësaj “filozofie” katastrofale politike, fetare, morale dhe, natyrisht, letrare, por të leverdishme për të - të kësaj “filozofie” servile, të pa dinjitet elementar, në thelb tepër fyese për shqiptarët në tërësi e jo vetëm për ata të besimit mysliman.

Për të gjitha arsyet e sipërthëna mund të thuhet se qëndrimet e përsëritura të Ismail Kadaresë kundër fesë myslimane, së cilës i përkasin rreth dy të tretat e popullit shqiptar, në njërin anë, dhe thirrjet për “korrigjimin e madh historik”, domethënë për kthimin në fenë e të parëve - në fenë e krishterë, në anën tjetër, përbëjnë përpjekje kundërkulturore dhe kundërhistorike në jetën kombëtare shqiptare. Ato janë qëndrime me ndikim jo më pak shpërbërës (çintegruës) në shoqërinë e sotme shqiptare se përpjekjet kundërhistorike:

- për krijimin e identitetit kombëtar kosovar,
- për krijimin e një gjuhe tjetër standarde për këtë identitet, dhe
- tejshqarjet, tejtheksimet e vetëdijes fetare.

Sado të paramenduara si qëndrime servile ndaj qarqeve të caktuara politike e intelektuale evropiane, ato në thelb janë qëndrime kundërdemokratike, që bien ndesh me filozofinë e sotme politike evropiane dhe amerikane, që është e ndërtuar mbi pluralizmin fetar, mbi lirinë e ndërgjegjes, mbi tolerancën dhe mbi trajtimin e barabartë të dinjitetit të feve dhe të njerëzve.

Komprometimi intelektual, politik dhe moral i ideve raciste të Ismail Kadaresë ndaj Lindjes jo vetëm turke dhe arabe dhe i qëndrimeve të tij mohuese ndaj pluralizmit fetar në jetën kombëtare shqiptare, komprometimi pra, i këtyre ideve dhe qëndrimeve kundërhumane dhe kundërdemokratike të Ismail Kadaresë, në përgjigjet e mia *Realiteti i shpërfillur* dhe *Të vërtetat e vonuara*, ishte më se i nevojshëm. Kjo, besoj, është arritur.

Të përsëris.

Në Evropën e bashkuar – doemos, por në Evropën e bashkuar do të hyjmë duke mos përbuzur popuj të tjerë siç bën Ismail Kadare.

Në Evropën e bashkuar – doemos, por në Evropën e bashkuar do të hyjmë duke mos mohuar veten siç bën Ismail Kadare kur mohon përbërësit myslimanë në identitetin e gjithësishtëm, historik, shqiptar.

Në Evropën e bashkuar – doemos, por në Evropën e bashkuar do të hyjmë duke zbatuar standarde evropiane, duke pranuar e duke krijuar vlera, vërtet, evropiane.

Në Evropën e bashkuar – doemos, por në Evropën e bashkuar do të hyjmë dinjitetshëm, pa servilizëm, pa gënjeshtër e mashtrime, që janë bërë mjete të politikës sonë.